



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-20699/24
Kaçanik, 05.09.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VIII (tetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2024 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 05.09 2024. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje kur u lexua evidenca, ishin 25 anëtarë. Në mbledhje munguan Bashkim Krasniqi dhe Besnik Salihu.

Nga Ekzekutivit i Komunës në mbledhje apo në pjesë të mbledhjes, morën pjesë: Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Zahir Doda-DA, Suhad Dullovi- DBPZHR, Sali Malsiu-DSHMS, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët: Bejtulla Dalloshi.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli - Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Mavije Murseli - Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli: Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajt mbledhja ka, e hapi mbledhjen e VIII (tetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës, data 05.09.2024. Fillimisht ju njoftoj që kemi thirrur mbledhjen e tetë të rregullt të Kuvendit dhe nuk e kemi thirrur KPF-në, për arsye se këto tema janë trajtuar njëherë në Komitetin për Politik dhe Financa. Meqenëse drejtorja e Financave ka kërkuar disa ndryshime në vendimet e më hershme, që i kanë kërkuar ministrinë, atëherë ne duhet domosdoshmërisht ti shqyrtojmë ato vendime edhe njëherë përmes Kuvendit. Një ashtu e kemi edhe një shfuqizim të një pike që është kthye më shumë vonës, mirëpo është kërkuar me u shfuqizua dhe duhet ta shfuqizojmë. Përveç kësaj mbledhje, në këtë muaj i kemi edhe dy mbledhje tjera, një për buxhetin që mbahet në fund të muajit dhe për pikat tjerat që parashihet në atë mbledhje, por edhe një mund të jetë edhe solemne, ashtu siç më njoftuan sot se vjen një delegacion nga Moosseedorfi i komunës Zvicëranë, me të cilën komuna e Kaçanikut ka marrëveshje të binjakëzimit dhe është kërkuar nga komisioni për partneritet që është me atë komunë, që të kemi një mbledhje solemne në komunë në mënyrë që ata përfaqësues të jen në Kuvend komunës dhe ti drejtohen Kuvendit. Po ashtu përveç këtij njoftimi, dua të ju njoftoj që sipas vendimit Kuvendit që kemi marr për një realizim të vizitës zyrtare Turqi. Ne, veç i kemi marrë masat dhe kemi vendos kontaktet dhe planifikojmë që këtë vizitë të zhvillojmë nga data 23/10/2024 deri 27/10/2024, ku do ta vizitojmë komunën e Bursës dhe Iznikut, që po besoj që në komunën e Iznikut kemi me bënë një marrëveshje për një binjakëzim mes komunës Kaçanikut dhe komunës Iznikut pastaj do të vizitohet Stambolli dhe me datën 27 do të kthehemi në Kosovë. Në këtë rast ka me lëshuar

edhe një listë këtu, ata që planifikojnë me marrë pjesë këtë vizitë të nënshkruhen në listë. Për këtë takim, është propozuar ky:

REND PUNE

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, Edona Luzha;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 6-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 28.06.2024, me vazhdime të datës 03 dhe 31.07.2024;
3. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 7-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 31.07.2024;
4. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-11622/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Elezaj, në emër të “Migros Group”, me përfaqësues Mustafë Rexhepi;
5. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-12092/24, të datës 31.05.2024, për Bartjen e Mjeteve nga Rezerva Komunale sipas Buxhetit të vitit 2024;
6. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-11717/24, të datës 31.05.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore nga Burimi i Fondeve 22 - Të Hyrat e Bartura nga Viti i Kaluar 2023 në Buxhetin e vitit 2024;
7. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-14274/24, të datës 28.06.2024, për Transferin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024;
8. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/03-14313/24, të datës 28.06.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024.

Lidhur me rendin e ditës e hapi diskutimin.

znj. Ardita Rrahmani: Përshëndetje për të gjithë, fillimisht i uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë kolegës asambleiste në këtë vit të fundit që ka mbetur. Kryesues, lidhur me rendin e ditës jam e interesuar të dijë se çka ka ndodh me tri pikat të cilat janë vazhdim, pra supozohet me qenë vazhdim. Çka ka ndodh, pse sot nuk janë në rend të ditës?

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse këto pika na kanë ardhur si të obligueshme për rishqyrtim nga Ministria Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, mirëpo akoma nuk kemi përgjigje! Kam menduar që ato pika ti trajtojmë në mbledhjen e ardhshme, pra në fund të muajit shtator, kur e kemi edhe miratimin e buxhetit, por meqenëse këto pika na kanë dal pa parashikim dhe nuk e kam paraparë ti trajtojmë në këtë mbledhje, por gjithsesi ato do të trajtohen se janë pika të hapura.

znj. Ardita Rrahmani: A keni ndonjë përgjigje prej Ministrisë?

Kryesuesi i Kuvendit: Jo nuk ka përgjigje.

Rendi i punës u shtrua në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 8 pikave.

1. Betimi Solemn i anëtarit të zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga subjekti politik, Aleanca për Armërdhin e Kosovës Edona Luzha;

Kryesuesi i Kuvendit: E ftoj anëtarin e zgjedhur nga AAK, Edona Luzha, të ngritët në këmbë dhe të lexoj deklaratën e Betimit Solemn, ndërkaq në shenjë respekti për betimin e anëtarit të KK, i ftoj të gjithë të pranishmit të ngritën në këmbë.

znj. Edona Luzha- Fillimisht i përshëndeti të gjithë të pranishmit, e lexoj tekstin e Betimit Solemn si në nenin 35.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si vijon: “Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”. Deklarata e Betimit Solemn u nënshkrua nga Edona Luzha / Lënda: 01Nr.60/01-21815/24.

Kryesuesi i Kuvendit: E falënderoj Edona Luzha për Betimin e dhënë, i dëshiroj suksese dhe punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;

Ndryshim Plotësimet e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së shtatë (7) të KK, të zgjedhur me 17 Tetor 2021/ Lënda: 01Nr.60/01-21814/24.

Në bazë të Vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 01/1246/2024 të datës 21.08.2024 pranuar me 26.08.2024 me numër të protokollit të komunës 01Nr. 060/01-20674/24, anëtari i dorëhequr nga AAK Rabije Sallahu, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i AAK, Edona Luzha. znj. Edon Luzha nga data e dhënies së Betimit dhe nënshkrimit të Deklaratës solemne, realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe kompensimin, ndërkaq znj.Rabije Sallahu, pushon të jetë anëtar i KK sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 me vendim të KQZ Nr. 01/1246/2024, të datës 21.08.2024.

Të gjithë anëtarët e KK që e morën fjalën për pikat në vijim, fillimisht e uruan Edona Luzha, i dëshiruan shëndet dhe suksese në aktivitetin e punës së KK. Gjithashtu edhe anëtarët e Ekzekutivit, duke filluar nga Nënkrjetari i Komunës, të gjithë që morën fjalën, paraprkisht e uruan anëtarin e re të KK, Edona Luzha, i uruan punë të mbarë, shëndet dhe suksese.

2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 6-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 28.06.2024, me vazhdime të datës 03 dhe 31.07.2024;

z.Agim Çaka: Te procesverbali, sa mos me than qe nuk e kemi lexuar dhe nuk e kemi vërejtur këtë lëshim d.m.th. te pyetja e Bashkimit, te stadiumi është përgjigjur Kryetari dhe thotë se stadiumi ka filluar në vitin 2029, ndërsa tani jemi në vitin 2024.

Kryesuesi i Kuvendit: Është gabim teknik dhe përmirësohet, mirëpo para publikimit është mirë me u përmirësua.

z.Bashkimi Luma: Lidhur me pyetjen qe është bërë për te stadiumi, nuk është shkruar e gjitha çfarë është thënë prej Kryetarit. Kryetari e ka cek qe është bërë devijim i projektit nga ana e projektuesit dhe kjo është arsyeja kryesore qe stadiumi nuk është përfunduar andaj kërkoj qe të bëhet ky përmirësim.

z.Agim Mani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, asambleistës znj.Edona Luzhes i dëshiroj mirëseardhje qe na u ka bashkëngjit këtë legjislacion. Në këtë mbledhje që është përpiluar ky procesverbal i cili është zhvilluar në tri faza, d.m.th. ne nuk kemi marr pjesë në të gjitha fazat e kësaj mbledhje. Për arsye qe ky procesverbal në përmbajtje ka shumë mangësi, ne nuk do ta votojmë.

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk ka, Abstenim 7 votë. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 28.06.2024 / Lënda: 01Nr. 60/03-14299/24.

3. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 7-të e rregullt e Kuvendit të Komunës i datës 31.07.2024;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar u aprovua. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës.

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së VII (shtatë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 31.07.2024 / Lënda: 01Nr. 60/01-11877/24.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Rustem Zenuni: Unë e kam një njoftim për Kuvendin pas zgjedhjes në KPF, deklaroj se tërhiqem nga komisioni për emërimin e rrugëve dhe komisioni i aksionareve në ndërmarrjen stacioni i autobusëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Mirë që e keni njoftuar Kuvendin, por sidoqoftë këtë është mirë me e dërgua me shkrim tek sekretaria e Kuvendit.

z. Rustem Zenuni: E dërgojmë edhe me shkrim te sekretaria e Kuvendit.

znj. Ardita Rrahmani: Unë kam dy shqetësime të cilat janë të përsëritura e të ripërsëritura, po thuajse ka kohë të gjatë që gjithë mandatin tim kam fol për to, e që punë konkrete kurrë nuk ka. Konkretisht ka të bëjë me shkollën fillore "Emin Duraku", d.m.th. e kam fjalën për objektin e vjetër ku nxënësit veç se kanë filluar mësimin, aty kushtet cilat janë e dini gjithsecili më mirë se unë, çka po ndodh për arsye se postime ndryshme po shohim por prapë asgjë konkrete nuk ka, a do të filloj nëse po kur dhe kur do të përfundoj?

Pyetja ime e dytë shqetësimi im i dytë i cili prek secilin që kemi qenë këtu dhe gjithë qytetarët, ka të bëjë me ujin. Kemi mbajtë pushim një muaj ditë gjatë muajit gusht, gjithsesi kemi pritur një përgjigje prej Kryeshefit për një takim, takim sikur ajo molla e ndaluar që është që nuk banë me u taku me ta dhe ende po vazhdojmë të merremi edhe të kemi probleme me ujin, çka po ndodh, pse mos ky koordinim, pse këto inate? Sipas mendimit tim kjo problematik është për inate politike sepse ndryshe nuk ka se si mu emërtua, të gjithë ballafaqohemi pa marr parasysh cilit subjekt i takojmë në fund të gjithë ballafaqohemi me të njëjtin problem, mandej kur vjen puna me kritikë cilin do akter që është përgjegjës për këtë problematik heshtim.

Pasi që kryetari nuk qenka këtu prezent, ju nënkryetar apo ju kryesues, a keni komunikuar në kanale zyrtare, pra a keni komunikim zyrtar me Kryeshefin përgjegjës këtu të Bifurkacionit në Kaçanik, për çfarë arsye ato nuk na presin në takim, pse hezitojnë, pse nuk duan, edhe pse unë nuk mendoj që është hezitim, por pse nuk duan me na taku, kush ju jep urdhër për mos

me na taku, a mundesh të lutem kryesues sepse nuk po besoj qe është një përgjigje qe të jep një muaj me ma kthy.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë po të drejtona në rrafshin tim sepse unë nuk jam organ ekzekutiv qe mund të vendosi për diçka ekzekutive, jam një si ju këtu me kompetenca pak ma të mëdha për shkak pozitës qe e kam, ata çka është dashtë me bë si kryesues dhe si Kuvend bashkë me juve e kemi bërë, pa inate politike dhe pa asnjë tendence të gjithë dhe jemi mundu me i dhanë drejtim zgjidhjes së problemit, për çështje tjera unë nuk kam ndonjë komunikim tjetër këtë rast as me shefin e Bifurkacionit Ferizaj e as me ata njësisë Kaçanik. Përgjegjëse për këtë janë Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe ekzekutivi komunal, të cilët mendoj qe me këta këtu kanë, por me ata atje nuk e di se qysh e kanë diskutimin prandaj munden me ju përgjigj vetë, është edhe nënkryetari dhe është ngjarje ma shumë por qe nuk na kanë kthyer përgjigje për takimin edhe pse kemi insistuar disa herë po ja kaloj fjalën nënkryetarit.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndetje për të gjithë, e në veçanti urime për asambleisten më të re të Kuvendit Komunal. Meqenëse unë i kam të përgatitura të gjitha dokumentet lidhur me çështjen e ujësjellësit për të cilat kemi edhe komunikime zyrtare, por nuk i kam me vete por nëse është nevoja shkoj i marr.

Te çështja e ujësjellësit siç e dini ju nga një vendim i qeveris të Republikës së Kosovës, ka kaluar nga ndërmarrja lokale në ndërmarrje qeveritare d.m.th. i gjithë menaxhmenti i KRU, jo vetëm i Bifurkacionit por në nivel Kosove, nga viti 2018, janë me rekomandim të qeveris, i gjithë menaxhmenti qeveritar edhe bordet qe i kanë nuk është regjional po është qeveritar, këtu mundet me më përmirësuar edhe drejtori i Shërbimeve Publike se normalisht është edhe ma në ngjarje. Kemi bërë takime të shpeshta me Kryeshefin ekzekutiv të regjionit Ferizajt dhe na është than vazhdimisht po mundohemi për te menaxhmenti i ujësjellësit, mirëpo ka humbje shumë të ujit. Në bazë të takimeve qe kemi pas, ata vazhdojnë me thanë qe ka sasi mjaftueshme të ujit të prodhuar por ka humbje të ujit, për menaxhim nuk kemi qasje nuk mundemi me than, me u bë damaqin në shtëpinë e huaj.

Ne si komunë nga viti 2020 i kemi investuar 550,000.00 €, në çështje të ujësjellësit nuk ka vend në ujësjellës në komunën e Kaçanikut qe nuk e kemi pa alternativ për me bë shtimin e ujit d.m.th. e keni të argumentuar edhe analizat qe janë bë nga IKSHPK-ja dhe organet që janë përgjegjëse edhe fabrika e gëlqeres, tash mundem me gabua sa litra në sekondë i qet edhe prej përroskës në Dubrav që janë dy gypa fi 100 vetëm me leshu ventilin, d.m.th. mund bëhet sasia e ujit por nuk e bëjnë një gjë të tillë sepse nuk është trajtuar mirë ki ujë.

E kemi një përroskë rezervë në fsh. Koxhaj qe nuk është funksional, e kemi një përroskë te vogël të nivelit komunal, të gjitha këto janë prej investimeve komunale pra të gjitha këto ne i kemi bërë dhe qe na takon neve për qytetarët e komunës së Kaçanikut, mirëpo ne nuk kemi dashtë me bë politik me ujë derisa u bë shumë e madhe te qytetarët e Kaçanikut, mandej edhe kemi reaguuar, përndryshe për gjithë ata qe janë në sistemin e Bifurkacionit e din krejt qe menaxhimin e banë Bifurkacioni.

Bifurkacioni nuk është kompani komunale por është kompani në nivel qeveritar. Më herët kemi pasur aksione te Bifurkacioni edhe kur kemi pasur aksione normalisht kemi pas qasje menaxhim tani i kemi dy kompani qe kemi aksione është stacioni autobusëve dhe pastërtia. Tek pastërtia ku kemi pjesë të menaxhimit, besoj qe shumica jeni të kënaqur por tek këto qe nuk kemi pjesë te menaxhimit veç kemi shtuar sasi të ujit por nuk kanë mundur me shti koordinim kete ujësjellës kete sasi te ujit.

Tani drejtori i Shërbimeve Publike i ka bërë analizat te pusi i gëlqeres, analizat kanë dal qe është ujë i pijshëm ndërsa ata vazhdojnë me thanë qe nuk është bash i pijshëm nuk po e shtinë në sistem tash ose duhet me dal për mendimin tim Bifurkacioni se në pikun e zhegut e kuptojmë edhe këtë se kanë pas mungesë të ujit mirëpo në qoftes e ne i kemi bë sistemet alternative në secilën pikë ku ka rrezik të mungesës se ujit atëherë pse nuk po del Bifurkacioni me një vendim me thanë qe një muaj ditë për shkak bashkatdhetarëve qe janë

këtu për shkak të numrit që shtohet i popullsisë mos e pini këtë ujë shfrytëzohet veç për higjien sepse ka sasi të mjaftueshme të ujit por as nuk e shtinë në sistem as nuk thojnë qartë për me dal me një deklaram të tillë, po ashtu e keni rezervarin 1 milion litër që është bërë nga betolënka kemi dërguar shkresa zyrtare me ardh me pas një inxhinier të hidros që qysh me muajt me shti funksion që me rrok pikën ma të lartë në qytetin e Kaçanikut ende kemi mbet pa përgjigje, e kemi ftuar edhe nga kërkesa juve Ardit dhe nga kolegët e tu e kemi ftua interpelancë nuk është përgjigj, një takim që kemi pas me administratorët që keni procesverbal për këtë d.m.th. ju ka thënë edhe Kryeshefi aty ku keni në menaxhim, ku ka kontratë në mes komunës dhe Bifurkacioni, çdo mungese që keni për ujë dhe çdo defekt keni punë me bifurkacionin nuk keni punë me komunën. Mirëpo normalisht shqetësimet e çdo qytetari moment që ndalet uji vërejte te Kryetari kanë a realisht kur ta paguan faturën nuk ja paguan komunës po ja paguan Bifurkacionit. Në kontratë e ka aty ku e ka bërë faturën aty e ka mirëmbajtjen aty e ka edhe menaxhimin nuk domethënë që ne jemi të kënaqem me gjendjen e ujit dhe nuk po duam me than se ne nuk kemi përgjegjësi por qatë që kemi menduar për shkak qytetarëve kemi bërë alternativa ndryshme, në secilin repart ku mendojmë që kemi leshu ujin janë të gjitha që i potencova jau argumentojmë edhe me shkrim këta që po e them vetëm se vyen me shti funksion realisht gjatë takimeve të ndryshme na është thënë se kemi më shumë se 60% , 70% humbje të ujit e tash imagjinone nëse ka 60 % të humbjes të ujit atëherë çfarë menaxhimi ka, këta mundeni me vërtetu edhe vet Ardit ne mundemi me bë edhe një takim të përbashkët ndash shkojmë Ferizaj apo këtu por realisht i ka dërguar drejtori emalin po nuk janë përgjigj.

znj. Ardita Rrahmani: Ju dëgjova me shumë vëmendje nënkryetar edhe juve kryesues, kjo po mendoj është si loja pin -pongut, po e gjuani fajin dikun tjetër tani dikush tjetër po e rikthen te ju, pse sepse nuk ju amnistion juve si komunë. Kjo çka kanë ndodh me menaxhimin këtë rast Bifurkacioni sepse problematiken e ujit e kemi pasur edhe pa u menaxhuar nga Bifurkacioni, e kam fjalën që nuk është që kemi qenë ua e jemi e po qaty qaty, po ajo çka e përmendët ju zakonisht qytetarët kur kanë mungesë orientohen për te Kryetari patjetër, që po se jeni Zoti shtëpisë edhe duhet me i dal ballë secilës problematik por kjo nuk e amnistion aspak edhe menaxhimin e keq që po bëhet në Bifurkacion, zotërinë i cili menaxhon nuk e njoh dhe nuk më lidh asgjë me ta dhe kjo nuk është personale që po e thamë, por personale është që ne shtëpi kur shkoj nuk kam me çka me pastrua vajzën time dy vjeçare dhe kjo gjë është personale se ajo kush e udhëheq hiç nuk me intereson. E kam parë edhe shkrimin e juaj apo postimin e juaj në rrjete sociale, mandej i kemi parë edhe dokumentet të cilat na ka dërguar drejtori për të cilin e falënderoj që najë ka përcjell, edhe unë mendoj me ja përcjell një emal filan listekut edhe po kërkoj me pas një takim, unë kam provua edhe masa më radikale ndoshta prej natyrës temë mundet me ju dok dikujt e çuditshme por jam gjendje me bë një masë radikale për mu masë radikale është me i shkua te dera edhe me i trokit në derë hapma derën edhe me ja thirr disa media aty, se vijnë krejt qysh kanë ardhur për libra, kush i ka lajmërua pak rendësi ka, por vijnë edhe për ujë se shumë ma me rendësi është. Katër muaj po bëhen, jo katër ditë as 4 javë po 4 muaj dhe ende kemi problem, në këtë rast po flas për lagjen e re e cila ende ka problem pasi që kam kontakt direkt me ta, e sa e sa lagje tjera janë nëpër Kaçanik. Kryesues unë jam për atë masë radikale, unë dhe ti po shkojmë mos të vjen asnjë, ai mundet me u arsyetua qysh të donë. Po takim duhet me na prit mandej takim mundet me naj listu këto. Kjo që po e thoni është sikur me nxjerr një arsyetim prej vetes thash ping pong me qua tek pala tjetër nuk na kthen përgjigje kjo është ping pong me muri e jo me njeri tjetër se në këtë rast Bifurkacioni na ka vu mur.

Kryesuesi i Kuvendit: Tash hapi parë që u kërkuar edhe këtu ke kjo, e ftojme nuk erdh, i shkruajmë po vijmë nuk na kthejti që po ju prit, tash po kërkon me i shkua shkojmë kur të

dëshironi, kurdo që vendosim këtu na një delegacion prej disa viteve, lëne të hënën të hënën shkojmë nuk e kam këtë problem.

znj. Ardita Rrahmani: Kryesues kaloj vera ne jemi tu ballafaqua me këtë problem dhe sa e sa vera kanë me na ardh?

Kryesuesi i Kuvendit: Ardita, ju keni punuar në institucione, ta gjen mundësin ligjore ke pas mundësi me prit 20 ditë apo 30 ditë me të kthye përgjigje dhe unë, e kemi prit dhe tash janë konsumuar afatet ligjore mundemi me shkua kur do që dëshironi ju me shkua. Unë jam për me shku, unë jam për me bë edhe gjera tjera, disa fshatra që kanë qenë Nikajve, Dubrav, Rekes, Doganajve, Elezajve.

Unë vetë takim me administratoret kam kërkuar prej tyre që shkëputini marrëveshjet që i keni bërë me Bifurkacionin, më mirë e kemi pasur gjendjen kur e kemi menaxhuar ujin vet kur kam dal unë vet në bjeshkë edhe e kam kontrolluar burimin a është dhe a ka hi në gyp apo nuk është.

Nënkryetari i Komunës: Ardit besoj që e dini shumë mirë se kush e menaxhon këta, një argument po ja jepi në vitin e kaluar ose para dy vite një prej shtatë fshatrave që vijë unë nuk është kanë në menaxhim të Bifurkacionit, të jesh e bindur që kemi pasur më shumë ujë se sa tani që kemi me kontratë me orë që është me pagesë, nuk kemi ujë edhe tjetra nuk mundemi me thanë që nuk na kanë hapur derën asnjëherë se unë bashkë me drejtorin e shërbimeve publike në Ferizaj kemi pasur takim, kemi pas edhe njësit këtu ligjërish nuk na lejohet me nda si njësi se besoj që krejt ishit kanë të pajtimit se nuk na lidh kurrigjë as me Ferizaj dhe Hanin Elezit, burimet i kemi në veti por nuk na lejohet ligjërish nëse na marrim vendim kundër ligjshëm, që po e marrim krejt dhe e di që menaxhojmë njëqind herë me mirë si komunë se fondet që po janë realisht, kanë fonde të mjaftueshme. Për mos me i përsërit të njëjtat fjalë kemi investuar prej nivelit lokal edhe drejtori i shërbimeve publike me kohë ka reagua i ka thënë ku i ki burimet alternative, nuk janë shti në funksion, çka tash nëse i shtinë funksion, kjo kohë ka qenë e panevojshme me hekë qytetari për ujë.

z. Ramadush Osmani: Prej debatit fundit që kemi pasur në asamble ne veç faktikisht kemi bërë kontakte zyrtare me institutin kombëtarë të shëndetit publik, kam kërkuar zyrtarisht si drejtor me i bë analizat e reja të pusit afër gëlqeres na kanë ardh analizat e para të cilat i posedojmë dhe prapë janë marrë edhe analizat tjera sepse zakonisht këto me ligj i bëjnë dy herë analizat, rrjedhimisht bashkëpunimi është lidh në trekëndëshin IKSHPK, Bifurkacion, Drejtori e Shërbimeve Publike si komunë dhe nesër e kemi një takim zyrtarë të tre akterëve, ku do të debatojmë këtë çështje do të vijë nga IKSHPK-ja, drejtoresha me stafin e saj dhe do të takohen pjesëtarët e Bifurkacionit.

IKSHPK-ja, e ka konfirmua takimin që i kam kërkuar zyrtarisht dhe në ora 10:00, i pres edhe Bifurkacionin në këtë takim është në kontakt me institutin kombëtar të shëndetit publik dhe do ta qartësojmë shumë qartë çështjen e rrjetit alternativ nga pusi afërt i gëlqeres. Unë si drejtor e kam mbajtur vijën e kontaktit me ta dhe pres që nesër të japin një vijë shumë qartë, kam thënë prape që aktivizimi i këtij pusi e zbut goxha mirë nevojën e ujit pijshëm në qytet edhe një do ta keni parasysh kemi kaluar një pjesë goxha të ashpër të thartësirës, që unë jam në teren edhe kemi mungesë të ujit në burimet ekzistuese është tu aplikua rezervimi në shumicën e lokaliteteve d.m.th. natën ndalet në mëngjes lëshohet por i zbut sado pak nevojat e tjera por këto do ti qartësojmë detajisht nesër në këtë takim tejet të rëndësishëm në mes këtyre tre akterëve, pastaj si pjesë e atij takimi shohim për veprimet e ardhshme.

z. Agim Çaka: Të njëjtën problematik kam pas me ngrit këtë mbledhje por e fillloi Ardita, kjo kaloj veç në debat por unë mendoj që nuk është keq pse e debatojmë edhe me qu krejt ditën komplet seancën. Për me debatuar për një problematik e cila është mjaft madhore dhe

mjaft esenciale nuk është një problem që ka ndodh një javë ditë, sepse munden me ndodh problemet një javë ditë uji Bifurkacioni, ki kompetenca nuk ke kompetenca edhe ata janë të kuptueshme që nuk mundem me u rregullu për një javë ditë, mirëpo kjo problematik është moti kohë prej vitit në vitë dhe po shkon duke u bërë vështirë e ma vështirë. Ne nuk i besojmë këtyre takimeve që kanë pas dhe kanë me pas, sepse besoj që takime ka pasur edhe me herët por problematika nuk është zgjedh përpara kanë thënë Kaçanik teferik ujë boll e bukë hiç, tash kemi mbet edhe pa ujë edhe pa bukë e mdoket nuk i kemi punët bash mirë nuk është pak me debat jo vetëm këtë seancë po edhe seanca tjera për këtë problematik. Kur po folni për Bifurkacionin po folni sikur me thënë Zoti e ka në dorë, ju duhet me kuptua që Bifurkacioni nuk është Zoti, Bifurkacioni ka njeri, ka menaxhiment, ka përgjegjësi, por veç është problemi te na që nuk jemi këmbëngulës dhe me shkua dhe me i thënë o djalë a çikë a kush je ti nuk ki shans ti prej Ferizajit, Kaçanikut me e lanë pa ujë. Në këtë kohë Ferizaj me pas ujë e Kaçaniku mos me pas ujë me të vërtet bëhemi për televizor e me dal nëpër media sikur që janë tu na qit mënyrën ma të keqe mundshme, si për te kalaja, si për te uji e sipër librari, u bam faqja e zezë, mos kujtoni se na nuk jemi këtu veç për mu ankua, ne jemi këtu për me zgjedh problem normalisht me zgjedh problem me anë ligjore, kush mundet me kanë përmbi ligjin kush është ai Bifurkacion edhe ne e kemi ditur që si ka kaluar te Bifurkacioni ka me qenë shumë ma keq, se ka qenë më herët por na duhet me bërë përpjeke duhet me bërë ankesa nëse ka nevoja me bërë kërkesë a ekziston mënyra ligjore me u kthye prapë menaxhim te na ata duhet me kanë të gatshëm me ju dhënë përgjigje se këqyr çka nëse e kthejnë tek na ka me qenë menaxhim më të mirë, kështu që mendoj që është një problematike duhet me na bashku të gjithëve si pozitë, opozitë, drejtori ekzekutiv, Kryetar, nënkryetar dhe qytetarë, mos bëhemi bash për gjynah me qesh gjithë me neve tu na mbyt uji tana anët, e mos me pas ujë.

Ta dini që hija keqe na bijën gjithëve, edhe neve që jemi këtu si asamblist pa marr parasysht fuqinë e votës që e kemi.

Kryesues, urgjentisht një lutje një kërkesë qysh doni thoni leni këto takime formale, jemi kanë kemi fol po besojmë që ka me u rregullua kjo punë, por kjo pune nuk rregullohet ashtu në pikë të ditës mos me pas ujë as për pije se nuk e di qysh shkon kjo puna e menaxhimit por bile së paku me pas me pijë.

z. Naim Beça: Autoritetin apo legjimitetin e këtij kuvendit e ka nënçmuar shumë keq drejtori, që nuk ka ardhur këtu me na vërtetu edhe kërkesën tonë, e me u përgjigj në pyetje tona rreth ujit. Sinqerisht po me vjen turp me diskutua për pika tjera, për mua ata pika tjera të rendit ditës janë koti krahasim me ujin d.m.th. i kemi tre muaj ditë që jemi pa ujë, i kemi për 24 vite shekullin XXI ende flasim për ujin. Çështjen e ujit e kemi përmend edhe këtë vit edhe vitin e kaluar edhe para katër muaj kanë kërkuar dhe kurrfarë mase nuk është ndërmarrë, vetëm i thash i kom than, kemi investuar nuk kem investua, nëqoftëse është investuar 500,000.00 € apo atë shumën që e përmende nënkryetar atëherë keni investuar kotë, i keni harxhuar parat kotë, se uji nuk qenka i mirë, kush e ka vlerësuar ata nëse është i mirë, pse nuk e lëshoni nuk është në rregull duhet me u zgjedh problemi këtë problem ma merr mendja mundet me zgjedh vetëm Kryetari i komunës, udhëheqësi i mirë është në kohet e vështira. Le të dalin me deklarata që ujë mos me pagua hiç krejt qytetaret e Kaçanikut, deri sa të kemi ujë, herën e kaluar kur e thash që nuk ja ndien për neve, keni qesh a besoni që nuk ja ndien apo e shihni se çka janë tu na bërë.

Kërkoj që një seancë me mbajt për çështjen e ujit. E dyta, që dy muaj ditë dhe jam i sigurt që krejt jeni kanë të sëmurë me barkqitje dhe vjellura, kërkoj prej drejtorit shëndetësisë, a kanë bërë ndonjë analizë për këtë çështje? Unë besoj dhe jam shumë i sigurt, por nuk jam ekspert i kësaj pune por kam biseduar me disa që merren me këto punë dhe kanë thënë që është çështja e ujit, pasi që uji nuk ka qenë i pastërt dhe shumicën e njerëzve i ke në ambulancë sot që janë të sëmur, a kanë bërë ndonjë masë apo ndonjë analizë se për çka dhe veç në komunën tonë është kanë kjo epidemi?

Një pyetje tjetër, te Bunari kanë filluar disa punime a mundet dikush me tregu pse janë ndërprere punimet, desha ta dije, për çka janë ato punime ura apo çka ka me u berë aty? Kur kanë me u përfundua këto projekte qe janë nis dhe nuk janë përfundua, dhe cilat janë ato, kjo është e dhjeta herë që e bëj këtë pyetje. I kemi disa projekte te sheshi janë nis dhe kurrë nuk janë përfundua kjo ndodh vetëm në Kaçanik, me u nis dhe mos me përfundua. Ura te ETC u nis ajo punë por kur doni me leshu, sheshi a është i përfunduar si projekt apo nuk është i përfunduar?

Kryesuesi i Kuvendit: E merr përgjigjën me shkrim Naim.

znj. Kadrije Lika Troni: Së pari i dëshiroj mirëseardhje koleges asambleiste Edona Luzhes i uroj suksese dhe mbarësi në vazhdim. Për deri sa jemi në shekullin XXI ende po debatohet për ujin edhe koleget e mijë asambleist i shterën të gjitha debatet ata çka pata me thënë ende nuk e kemi qartë përgjegjësin e Bifurkacionit.

Bifurkacioni a ka përgjegjësi me i dhanë llogari komunës apo jo, e dyta nënkryetari e mori fjalën mirëpo unë po shoh brenda ekzekutivit nuk janë të një fjale për derisa nënkryetari thotë se burimet janë plotë, po ka humbje ndërsa drejtori thotë burimet janë shtjerr d.m.th. ende brenda ekzekutivit shihen kundërshtimet, gjithashtu edhe nënkryetari nuk është i njoftuar se nesër ka takim edhe koordinimi te trekëndëshi është në bisedë e sipër, unë uroj qe të shtohen sa më shumë masat e ujit dhe qytetarët mos ta kenë këtë problem dhe shpresoj qe do ta bien me një pikë pozitive ku qytetari përfundon me këtë.

Kryesuesi i Kuvendit: Po nisna prej gjendjes qe unë shoh në rajonin tim ku jetoj, edhe pse andej është gjendja ma e butë ne kuptimin e ujit nuk ka as andej por është ma butë nga ajo çka e dëgjoj këtu çdo ditë. Kështu nga ajo çka e shoh nga papërgjegjësia se nëse një defekt i vogël ndodh dikun, shkon me jave deri sa të intervenohet në atë defekt ka pas probleme edhe në rezervarët e ujit, e me javë kanë dal vet me punë vullnetare, disa çështje qe absolutisht nuk kanë kompetenca në atë drejtim por njerëzit tu dashtë me bë zgjidhje dalin dhe e kryen punën se nuk e pyesin askënd më për këtë. Për këtë arsye po e theksoj papërgjegjësia është goxha e madhe në raport me kompaninë menaxhuese, kujt i japin llogari ata, secili institucion i jep llogari atij institucioni i cili e themelon. Përderisa e kemi pas bordin e aksionareve e komisioni i aksionareve në raport me kompaninë ka pas përgjegjësi ndaj nesh, sepse i kemi pasur njerëzit aty ku ne kemi mundur me thirr dhe me i krye, tash është themelua nga qeveria prej viti 2018 edhe tash ato i japin llogari institucioneve qendrore jo institucioneve lokale. Në bazë te asaj qe unë e di dhe shoh dhe nuk po dua me kritikë vetëm një person qe është atje në krye, se ndoshta edhe ai nuk e din se qysh e ka gjendjen në teren, por ai të paktën le të kërkon llogari prej punëtorëve tij se nuk janë kërka.

Për një intervenim qe duhet për një orë duhet me prit qytetari tre deri në katër javë kjo është papërgjegjësia.

znj. Ardita Rrahmani: E dëgjova me vëmendje drejtorin kur tha për takimin e nesërm dhe e dëgjova kur tha për emalin qe ja ka drejtua IKSHPK-së, e kam veç një pyetje pse kjo kërkesë nuk është realizua më herët kundrejt IKSHPK-së, mandej me pa qe nuk ka kurrfarë kontakti me Bifurkacionin pavarësisht se kush është, por kur janë shtjerr ato e keni pa qe do të thotë jeni me një rrugë pa krye dhe keni fillua mandej edhe me IKSHPK-në, pse jo me herët, pse mos me u marr ma herët kjo masë?

z. Ramadush Osmani: IKSHPK-ja, është fondi kombëtar i shëndetit publik departamenti banë analiza të ujit arsyeja pse unë ju kam adresua IKSHPK-së, ka qenë me i marr analizat te pusi për arsye se Bifurkacioni e ka laboratorin e vet dhe unë kam dashtë me i krahasuar analizat nga një institucion kredibil, sepse mund të kenë fjalë është i pa licencuar ai laborator nuk i besoj.

Unë kam kërkuar zyrtarisht dhe kam hasë në mirëkuptim jashtëzakonisht të lartë nga ky departament, i cili e ka marr shumë përsipër dhe ka bërë analiza shumë të detajuara, diku 5 lloje të analizave janë bërë të cilat kanë me u ripërsëritur prapë vetëm e vetëm që sasia ekzistuese alternative me u fut në funksion, për me u fut që mos ta ketë dilemën Naimi pse kanë barkqitje ose me i marr analizat të sistemeve alternative nga ky institut i cili është kredibil, dhe kjo është arritur. Ne i presim nesër zyrtarisht deklarin e këtij instituti si të veprohet me këta sisteme alternative.

Sa i për ketë çështjes bashkëpunimit të Bifurkacionit, me ardhjen e shefit ri këtu në Kaçanik, unë kam bashkëpunim të përditshëm dhe mund të them kam bashkëpunim tepër korrekt, unë e njoh si institucion i cili përgjigjet në këtë, si komunë unë e njoh njësinë operative në aspektin operacional dhe në aspektin vendimmarrës, e njoh at shoqin atje të cilin kemi kërkuar me taku por në aspektin operacional të njësisë së Kaçanikut kontaktoj me të dhe është i gatshëm vazhdimisht bashkëpunojmë s'bashku.

Dua të ia bëjë pyetjen asambleistes znj. Kadrije Troni, a je konsumatorë e Bifurkacionit apo je konsumatorë e një sistemit privat, këtë dhën nuk e kam por mundem me verifikua dhe nëse je konsumatorë e Bifurkacionit kjo është në rregull d.m.th. nuk e di që konsumatorët e Bifurkacionit mbi 60% ka humbje Kaçanik, për keqpërdorim të cilat ndikojnë direkt në buxhetin e Bifurkacionit. Kur flasim për përgjegjësin e dikujt duhet të flasim, unë ku jam tu pijë ujë. Je asamblesite, ndërsa nuk futesh në sistem të menaxhimit nga një kompani.

znj. Kadrije Lika Troni: A është detyrë e imja me u fut në sistem, dhe a është detyra e juaj që para vitit 2018 ekzistonte ky ujësjellës që unë furnizohem me ujë, a e keni pasur ju para vitit 2018 furnizimin?

z. Ramadush Osmani: Konsumatori i bënë kërkesë zyrtare ndërmarrjes menaxhuese, hajde kyçem dhe vendosma orën, që unë mos keqpërdori ujë pa masë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pavarësisht se cila është mënyra apo arsyeja, institucionet janë përgjegjës për menaxhimin e ujit dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e ujit janë kompanitë rajonale të menaxhimit të ujërave. A është kyç një qytetarë apo nuk është kyç në sistem prapë ato janë përgjegjës, a ka humbje apo nuk ka prapë ato janë përgjegjës, sepse ato janë për me menaxhuar për me mbikëqyrë edhe keqpërdorimin, për këtë arsye po thamë që qytetari nuk është fajtor pse ska ujë dhe qytetari nuk është fajtor pse njeri ka ujë e tjetri nuk ka kompanitë dhe institucionet janë përgjegjëse .

z. Brahim Imishti: Lidhur tek keq menaxhimi kam një shembull shumë konkret, komuna na kanë dal në ndihmë për hapjen e kanalit për shtrirjen e gypave të ujësjellësit, na ka ofruar gypat e ujësjellësit, na ka mbuluar kanalet, ndërsa kompania ka dy javë që nuk vjen me bërë kyqjen sekondare, andaj nuk di kujt me ja gjuajt topin, përpos keq menaxhimit të Bifurkacionit.

z. Seljadin Troni: Drejtor, dhe unë nuk besoj që duhet me pyet një asambleiste, ku je e lidhtë me ujë, me të thanë drejtën po me vjen keq por po ta them, unë besoj që veç prej votave që i ka marr ka drejt me pyet për qytetar hiç për veten, unë personalisht e kam të lidhtë me një lagje që e kemi bërë vet kemi investuar shumë që me pas ujë të rregullt kurrë pa u ndal. Në qoftë se e kemi një problem, e zgjedhim brenda lagjes edhe po ta merr Bifurkacioni unë ta garantoj që kemi me pas problem. Unë kërkojë kush e menaxhon dhe me rregullu punën për gjithë e jo veç për vete dhe prandaj ka drejt shumë me pyet.

z. Naim Beça: Para dy vite e kam bërë pyetje, pse komunat e tjera janë të lidhura me ujësjellësin e Kaçanikut, përgjigja që me ka ardh është e pakuptimtë pak, por në rregull si përgjigje diplomatike d.m.th. sipas përgjegjësit z. Ramadushit që u përgjigj aty mu më ka thënë

qe nuk ka drejt Bifurkacioni me bë lidhje prej komunës tonë komunë të Vitisë, mbasi qe nesër keni takim drejtor diskuto për këtë çështje.

z. Agim Mani: Unë e kam vetëm një pyetje rreth çështjes së ujit d.m.th. a është komuna aksionare me Bifurkacionin?

Nënkryetari i Komunës: E theksova dhe me herët nuk është komuna aksionare me Bifurkacionin.

z. Agim Mani: D.m.th. komuna po investon ne rrjetet e ujësjellësit në komunën tonë goxha shumë dhe nuk është aksionare, nëse investon në rrjetet ujësjellësit duhet me kërkua nga organet ma të larta. Nëse investon ti je bashkëfinancim të projektit duhet me dhënë llogari, me para të qytetarëve po investoni nëpër burime të rrjetit dhe nuk kërkoni llogari.

Nënkryetari i Komunës: Agim unë u mundova në fillim me laboru, por tash nuk po e di a jemi përgjegjës, sepse në njërën anë kërkoni qe ju te jeni përgjegjës se jeni "damaqin" është Kryetari këtu, ndërsa në anën tjetër thoni a jeni aksionar a nuk jeni aksionar, nuk keni të drejt me investua këtu d.m.th. na për shkak qe ndiejmë obligim se nuk po dojmë me ik kësaj shtate se uji është element kryesor për jetë ajo nuk diskutohet dhe kemi bërë alternativa të ndryshme dhe jemi në koordinim ndërsa aksionar nuk jemi. E potencova dhe në fillim për nuk me keni dëgjuar me vëmendje, aksione nuk kemi sepse kanë kaluar nga niveli lokal ne atë qeveritar, mirëpo për shkak qe ndiejm obligim dhe përgjegjësi për me bë shtim te kapacitetit të ujësjellësit, përkundër qe kemi emal-kërkesë edhe nga drejtori direkt të Bifurkacionit, për ndërtimin e një fabrike në lokacionin Sepetin ku merret uji nga Reka madhe qysh e quajnë dhe e njohin gjithë qytetaret, për me ardh me rënie të lirë mirëpo ajo fabrikë kushton dikun 2 milion euro dhe 2 milion euro komuna e Kaçanikut, nuk ka mundur ata na kanë thënë qe ka me hi këtë vit ka me hi vitin e tjetër mirëpo ende nuk ka hi për me u bë zgjidhje definitive duhet me ndërta një fabrikë për përpunim të ujit në Sepetin dhe me marr ujin me rënie të lire prej Rekës madhe dhe heqin të gjitha pompat edhe për Kaçanik të Vjetër edhe ku do qe shkojnë me rënie të lirë dhe qe zvogëlohet edhe kostoja për qytetarë mirëpo e thash edhe me herët në bazë të Bifurkacionit në bazë të menaxhimentit ma të lart Bifurkacionit gjate takimeve tona sasia e prurjes së ujit përputhje me formulën qe e kanë ato bazë për kok të banorit është më shumë se kudo tjetër mirëpo ka humbje të ujit nëse doni dhe ju e bëjmë një komision prej Kuvendit bashkë me ekzekutivin.

z. Burim Shehu: Pyetja është për drejtorin e Urbanizimit në lagjen "Ramadan Agush".

Ismet Tusha Faik Mjaku, Muhamet Hashani, kanë bë ankesa shpeshherë për një shkarpë për me ndërta dhe ju keni premtuar qe keni me ndërta atë shkarpë ndoshta, besoj që e din drejtorin se për kanë e kam fjalën. Kanë lyp një sqarim sepse janë te rrezikuar prej shembjeve të shtëpive dhe është shumë rrezik.

znj. Kadrije Lika Troni: Kam një pyetje për drejtorin e Arsimit dhe një pyetje për Kryetarin së pari urime për një vit të mbarë e të suksesshëm shkollorë 2024-2025, për juve si drejtori e Arsimit dhe juve nxënës e mësimdhënës përderisa urojmë për një vit të mbar nuk mundem me anashkalua edhe një shqetësim qe me ka trondit mua së pari si nënë e së dyti si asamblesite dukuria negative e ngacmimit seksual nëpër shkolla ky akt i shëmtuar e për fatkeq del të jetë prezent edhe ne shkollat tona ku para disa dite sipas raportimit të Policisë mediave në shkollën e fshatit Dubrav të komunës së Kaçanikut është denoncuar një ngacmim seksual i një nxënëse nga mësimdhënësi i saj kjo është një çështje e rëndësishme e cila duhet të adresohet me seriozitet dhe vendosshmëri në këtë seancë të Kuvendit pra kërkojmë nevojën për drejtësinë arsim përgjegjësi, për punën dhe veprimet e mësimdhënësve për masat

e nevojshme për të siguruar sigurinë dhe mbrojtjen në mjedisin shkollor për të gjithë nxënësit situata të tilla të ngacmimit seksual janë të pa tolerueshëm dhe të rënda prandaj drejtor na tregoni hapat të cilat i keni ndërmarrë në lidhje me rastin ju si drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe pyetja e dytë ka të bëjë për Kryetarin meqë Kryetari nuk është prezent shpresoj se përgjigjen najë kthen me shkrim. Me 10 Gusht dita e dëshmorëve Brigadës 162 "Agim Bajrami" ku institucionet komunale organizuan disa aktivitet ndër to edhe homazhe pran shtatorëve komandantëve Agim Bajrami e Qamil Ilazi dhe busteve të veprimtarëve të çështjes kombëtare duke filluar nga Idriz Seferi, Sali Bajra e Ismajl Raka, pse Kryetar është harruar figura emblematike e patriotizmit e luftës për liri komandant Avdyl Dura, pikërisht në këtë ditë ku as nuk përmendet e as nuk nderohet harrimi i aktivistit dhe figurës së çështjes kombëtare Avdyl Dura është një gabim i pakuptueshëm dhe i pa pranueshëm institucioni komunal në krye me juve Kryetar duhet të kujdeset për të nderuar të gjithë ata që kanë kontribuar në historinë kulturën kombëtare duke përfshij edhe Avdyl Duren. Ky harrim ose ky gabim duhet të theksohet si një mungesë e rëndësishme e respektit për figurat historike në komunën tonë kërkoj nga Kryetari përgjigje me shkrim pse është harruar kjo figurë nga ju si Kryetar.

z. Betim Shala: Përshëndetje për të gjithë, deshta me bë një pyetje lidhur me caktimin për ndërtimin e rrugëve lokale me kontratën asfaltimi dhe rregullimi i rrugëve lokale. A mund ta dijë me çfarë kritere është duke bë caktimi i atyre rrugëve, meqenëse unë kam bërë kërkesë, ju kam njoftuar në fakt për një rrugë konkretisht rruga "Sylejman Kuka" e cila gjendet në zonën e parë Kaçanik, sipas planit zhvillimorë urban brenda zonës parë qytetit. Meqenëse rrugën nuk po doni me rregullu bile me rregullua kanalizimin. Në atë rrugë nuk mundën me i hap dritaret kërku për shkak kundërmimeve të kanalizimit nëse ajo nuk është kanë prioritet, atëherë si caktohen prioritet?

znj. Ernesta Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë dhe i uroj mirëseardhje anëtares ma të re. Sot në këtë mbledhje dua të flas diçka të rëndësishme, ku kjo ndoshta e deshifron komplet mendësinë se si qeveris kjo komunë. Mekanizmi se si krijohet klientelizmi ku qytetari dhe sovrani bëhet klient sepse vetëm në këtë mënyrë qeverisjet mendje prishura dashakeqëse mund të qeverisin ajo që pash në dokumentin e publikuar për subvencione, shpërfaqja për disatën herë grykësin ata për të cilën me të vërtet jeni kampion të padiskutueshme edhe në subvencione për ndërmarrje të vogla ku prosupozohet të ju jepet ndihma bizneseve pa përkrahje dhe me vështirësi. Ju nuk na befasoni asnjëherë dhe as kësaj here sepse lista e përfituesve të përkrahjes financiare ishte sa e gërditshme aq edhe trishtuese, egoizëm i çoroditshim. Me të thënë së drejti nuk e di se a është drejtoresha e Zhvillim Ekonomik, ajo e kishte pas pak më së rendi për shkak se gjithë kolegët e saj kishin aplikua për të marr subvencione dhe nuk kanë mundur me i nda , me i nda si me i vra njëjtë ndoshta. Kryetari por që nuk është sot prezent, Kryetari jonë inovativ herave tjera duhet mendon më mirë, do të propozon me i bë një pesëmbëdhjetë drejtori, që të pesëmbëdhjetit të jenë përfitues të subvencioneve, të jenë drejtor komunal. Nëse nuk po e dini për cilën listë po flas është pikërisht kjo lista që nuk e keni parë, po i cek disa prej emrave Euron Livoreka mik bashkëpunëtor i drejtorit të Financave, Jehona Dullovi kunata e sekretarshes të Kryetarit, Miranda Sallahu vajza e drejtoreshës të Kulturës, Zejnepe Doda gruaja e drejtorit të Arsimit këto lista nuk janë veç për këto subvencione, janë për çdo subvencion, për çdo konkurs, për çdo pronë, këtë valle e luani gjithmonë, lenia pak rendin qytetarëve, veç kaq di me ju than, lenia pak rendin qytetarëve, le të përfitojnë pak qytetarët.

z. Fatmir Bunjaku: Lidhur me këtë, çka the a banë me ditë Bardhyl Kyqyku ku bën pjesë?

znj. Ernesta Krasniqi: Unë thash disa po i përmendi, nëse ke diçka me përmend lirishtë përmende.

Kryesuesi i Kuvendit: Dëgjo Ernesta kur te fillosh me lexu listën lexoje komplet se jemi në teleprezenc edhe për hir të korrektësisë edhe për hir të sinqeritetit lexoje listën komplet mos fillo me lexua, etiketua veç disa njerëz.

z. Agim Mani: Për me nxit këtë debat e nxit drejtori i financave i cili publikisht tha mbylle gojën por po ja falem ne pasi kërkoj falje se ke një gabim i tillë i cili në pa mundësi të ballafaqimit në argumente doli nga vetvetja. Sa i për këtë çështje që i cekti Ernesta te na kanë dal në pa qe kanë qenë të pa rregullta. Kriteret janë të përfitojnë bizneset të cilat janë të vogla ne i kemi vërejtur këto nëse ju i keni vërejtur emrat tjerë atëherë prapë faji mbetet i juaji. Ne i kemi vërejtur këta katër emra por edhe ju nëse e keni vërejt qe ju ka dhanë prapë është barra juve.

Kryesuesi i Kuvendit: Edhe ju nuk po jeni me një fjalë nëse janë këto katër parregullsi thuaj me tjerët jemi në rregull.

z. Selajdin Troni: Nuk është kjo komision qe me ditë kush është në rregull dhe kush nuk është në rregull. Nëqoftëse është një listë qe nuk i pëlqen nuk mundesh me i marr dy apo tre persona, qe keni ndonje gjë personale duhet me u përmend komplet lista, sepse po të garantoj me shumë se gjysma janë ndoshta që ju përkrahin juve, e ju nuk i përmendni emrat e tyre, por ju shkoni i përmendi dy tri emra qe ju pengojnë pa nevojë, për mua është e padrejtë të lexohet lista me dy tri emra, duhet gjithë listat të lexohet.

Kryesuesi i Kuvendit: E para pikë nuk është mirë na me fol me emra qytetarëve këtu qofshin ka ne apo ka ju se jemi në Kuvend komunal lista është publike. Sepse ndonjëherë e lëndoni najë kanë padrejtë mos mendo qe gjithmonë përmend emra ti ke të drejt edhe ajo nuk ju falet jo ty po të gjithëve ndonjëherë e keni të keq informuar e lëndoni dikan padrejtësisht e nuk është mirë me lëndua dikan padrejtësisht publikisht seancë Kuvendit sepse mos mendoni se gjithmonë që thoni keni të drejt as ju as na kështu qe ju kisha lut kursenu për shkak debatit politik qe u bë. Prapë është e drejt e juaja vazhdoni qysh doni por këshill e imja ishte kjo, ka dal drejtori Arsimit me kërkua fjalën për shkak se u përmend.

z. Zahir Doda: Përshëndetje për të gjithë, të lutem nëse dikun shkruan edhe e gjen qe më mohet e drejta. Zejnepe Doda është gruaja ime ka biznes i plotëson të gjitha kriteret për me apliku nëse dikun gjen, të lutem më denonco mos jep vlerësimet publike në Kuvend ekzistojnë organet tona na denonco për parregullsi nëqoftëse gjeten në përgjigjem e juve nuk ju përgjigjem sepse nuk ju mohohet e drejta as djalit Kryetarit as fëmijës drejtorit as për bursë. Une jam për meritokraci ju duartrokini për meritokraci, prandaj kush do qe e meriton sa për informacion subvencionet kanë mbet sepse njerëzit nuk kanë pasur mundësi për me apliku nuk e di unë, nuk e kan të regjistruar biznesin ndërsa unë e kam të gjithë dokumentacionin në rregull, të lutem më denonco në organet te krimet. Të lutem si asambleiste keni të drejt çka do të thoni por kur të përmendeni emrat përveçëm kërkoj që të më paditni për parregullsi ose do të ju padis unë juve për fjalën publike që e thoni ju keni me pas padijë prej meje qe trillon dhe e thua pa argumente atë gjë.

z. Rrustem Zenuni: Nëse ka parregullsi në kriteret ju përgëzoj dhe ju mbështeti me vepru, a nëse e keni veç për emra qe janë në listë unë ju vlerësoj qe jeni pa aftësi. Këta jeni te bë propagandë nëse ki problem te kriteret unë se bashku me juve ju bashkëngjitëm me shku me i denoncu kriteret a për emrat e përzgjedhur mendoj qe është gabim sepse unë i besoj institucioneve.

4. Kërkesa e MBPZHR për Rishqyrtimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-11622/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Elezaj, në emër të "Migros Group", me përfaqësues Mustafë Rexhepi;

Kryesuesi i Kuvendit: Siç e dini ky vendim është marr dy mbledhje më herët, vlerësimi i ligjshmërisë së këtij vendimi nuk ka ardh hiç, ka ardh krejt tash në fund dhe është kërkuar nga MAPL që ta shqyrtojmë domosdoshmërisht, për shkak se nuk është pajtim me dispozitat ligjore edhe pse është pas afatit vendimi nuk ka nis me prodhuan efekte juridike, atëherë për mos me qenë në grupin e komunave që si shqyrtojnë vendimet dhe mos me hup garën për grant të performancës, edhe pse plotësisht kemi të drejt ligjërisht për mos me rishqyrtu sepse ka ardh me vones, na e kemi sjell kuvend prapë me shfuqizua atë vendim. Nëse ka dikush rreth kësaj pike urdhëroni.

z. Agim Mani: Fillimisht po e shprehi si shqetësim si anëtarë i Kuvendit lidhur me veprimet e fundit të ekzekutivit dhe proceset e marrjes së vendimit të Kuvendit Komunal, kjo kritik është e domosdoshme për të ndihmuar përmisuar procesin dhe për të siguruar se çdo vendim që merret të jetë në përputhje me ligjin dhe interesin e qytetarëve.

Në dy tri mbledhjet e fundit, Kuvendi komunal ka miratuar disa vendime të cilat sipas vlerësimit tonë nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ne kemi ngrit këtë shqetësim që në momentin që kemi vërejtur dhe kemi votuar kundër këtyre propozim-vendimeve dhe argumenteve, duke argumentuar se këto vendime ishin të pa përshtatshme dhe të pa bazuar në mënyrë të plotë në aspektin ligjor, gabimet e para në këto vendime. Tani kërkoj thirrje për një mbledhje të veçantë d.m.th. për gabimet e juve na keni shti, që sot me ardh me një mbledhje të veçantë sepse nuk jeni bazua mirë si anëtarë të Kuvendit për shfuqizim të atyre vendimeve, që i keni marr vetë ju dhe duhet të veprojmë në mënyrë më të mirë.

Ekzekutivi ka neglizhuar rendësin e procedurave ligjore dhe ka vepruar në mënyrë që nuk i ka marr parasysh plotësisht interesat e qytetarëve, vendimet cilat janë miratuar pa një bazë të fort ligjore kanë krijuar një situatë dhe jemi detyruar ti shikojmë dhe ti korrigjojmë vendimet. Ky proces është një shenj e qartë e menaxhimit të dobët dhe të pa mjaftueshëm i çështjes së rëndësishme i prioritetit, na kemi kërkuar vazhdimisht transparencë dhe përgjegjësi në vendimmarrje të Kuvendit, dhe kemi theksuar nevojat për të ndjekur procedurat ligjore në mënyrë rikuroze. Është thelbësore që ekzekutivi të marr konsideratë këto kritika dhe të ndërmarr hapa për përmisimin e procesit të tij, për të shmangur në një ndodhi të ngjashme siç është kjo e tashmja.

Si opozitë, angazhimi ynë është të siguroj çdo mendim të jetë në përputhje me ligjin dhe të reflektoj në interesat e qytetarëve. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë këtë parim dhe kërkojmë transparencë dhe llogaridhënie nga ana ekzekutivit. Ky propozim vendim për rishqyrtim, tash po lidhem tek pika katër për shkak se krejt pikat që i kemi sot rend ditës kanë qenë jo në përputhje me legjislacionin fuqi të cilat kemi me i trajtua me radhë.

Tek pika e katërt kërkesa e Ministrisë Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shqyrtimin e vendimit 01Nr. 06-350/02-11622/24, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Elezaj, në emër të "Migros Group", me përfaqësues Mustafë Rexhepi. Ky është vendimi të cilin e kemi marrë ju si Kuvend dhe na ka ardh me shfuqizua, ky është një veprim, që është marr këtë Kuvend me shumicë votash pa u siguruar mirë në aspektin e ligjshmërisë. Ne si grup i Lëvizjes Vetëvendosje kemi qenë të bindur se ky propozim vendim për ndërrim destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore nuk mund të miratohet në këtë formë, pra kemi votuar kundër këtij propozim vendimit që e kanë sjell në Kuvend për rishqyrtim dhe këtë më së miri e konfirmon Ministria Bujqësisë, se ky propozim vendim e destinimit nga toka bujqësore në atë ndërtimore është në kundërshtim me dispozitat ligjore këtë e ka dhënë edhe ministria.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksoj se edhe mendimi i ministrisë ka konfirmuar mendimin e LVV-së tonë, d.m.th. si grup që ne kemi qenë në përputhje me legjislacionin duke pas parasysh vendimet e Kuvendit komunal përveç shqyrtimit ligjor në MAPL, është e rëndësishme që ne si këshilltarë komunal të shqyrtojmë në mënyrë të kujdesshme para se ti votojmë duhet ti lexojmë dhe ti analizojmë mirë këta vendime edhe në aspektin e ligjshmërisë, për të mos lejuar që këto vendime tona të kthehen shpesh herë nga MAPL-ja. Kjo është e rëndësishme për reputacionin tonë si anëtarë të Kuvendit sepse përveç Kuvendit komunal këto propozime kalojnë nëpër filtra të ndryshme të ekzekutivit komunal, për atë kërkoj që vendimet e tilla janë në kundërshtim me legjislacionin dhe të shfuqizohen dhe mandej me vonë të shqyrtohet ligjshmëria të këtyre vendimeve dhe të hapin rrugët investitorit të komunës tonë duke i orientuar në mënyrë të drejtë dhe të japim këshilla profesionale dhe ti ndihmojmë për realizimin e projekteve që është në interes qytetareve.

znj. Ardita Rrahmani: Kryesues lidhje me këta po e shtjerri diskutimin, tash vlen për gjitha pikat ka të bëjë me kthimin rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit si Lidhje Demokratike e Kosovës, gjithë i kemi votua për arsye se cili do investim që vjen Kaçanik minimumi dy apo tre punëtor që i shti në punë ne jemi pro asaj, por në përputhje me ligjin. E kemi i diskutu mandej që kjo ka shansa me u kthy por që ka ndodh nuk është e para dhe nuk është e vetmja por as nuk do të jetë as fundit, por prapë po rikthehem në atë që vjen si pasoj e mungesës së PZHK-së, se në raste se e kemi hartu PZHK-në ministria nuk ka pse me najë kthy, se na veç se kemi legjislacionin fuqi dhe bazë të atij legjislacioni, nuk kanë kurrfarë arsytimi që ato munden me u kthy, kështu që prej sot po ju bëj thirrje gjithsecilit hajde po e bëjmë PZHK-në, mandej edhe të tjerët arsyetohen për krijimin e mundësive për biznes por edhe qytetarët përfitojnë. Këto tjerat mirë e than janë elektorale prej neve prej juve edhe ju s'jeni ma të mirë, tanë vitin kështu keni me bë, po ju lus prapë secilin prej z. Krivenjeva e deri tek z. Mani, këtu tu ju përfshire edhe juve duke mos ju amnistua në asnjë moment, sepse ju jeni ata që e keni barrën kryesore, po hajde të bëhemi bashkë e ta hartojmë PZHK-në, mos ti marrim as bizneset në qaf po as qytetarët.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne për PZHK-në e kemi debatua shumë kohë, dhe asnjëherë nuk i kemi gjetë zgjidhje aty problemi sepse nuk po varet krejtësisht veç prej neve por veç një send e di që qatë moment që dorëzohet te Kuvendi, në afat rekord e keni edhe debatin publik edhe mbledhje jashtëzakonshme kemi me miratua. Nuk është problemi as te drejtoria as te komuna por janë çështjet me ministri me komunë ka ngec. Te vendimet që po i marrim paraprakisht po e diskutojmë edhe po e thojm që po mendojmë që kanë me najë kthy, mos mendo Agim që jemi bash padijshëm se ne po e dimë por po mundohemi me i dhënë kahje edhe zgjidhje probleme ka pas raste që najë kanë kalua por ka pas raste edhe që i kthejnë e dimë por s'jemi tu pas tjetër zgjidhje me bë, s'jemi tu pasur tjetër mundësi me bë. Për këtë ka qenë një projekt me panele solar prodhimi i energjisë elektrike nga drita që për mua ka qenë projekt i kapshëm e provojmë najë kthejnë, ne këtu jemi edhe pse najë kanë kthy me tre muaj vones kam pasur mundësi mos me shqyrtuar hiç sepse 15 ditë vendimi hi fuqi me pas filluar zotëria me punu nuk ja kishim kthy hiç por ka kërkuar sekretarja e MAPL-së, ka kërkuar mirëkuptim vonesa se nuk e ka pa e kam edhe në emali adres nëse dëshiron me pa s'kemi pa që ka veprime juridike e shqyrtojmë për shkak se na përjashtojnë në garën e performancës ne garën që fillojnë garantin e performancës kjo ka qenë arsytimi.

z. Qamil Stagova: Është e vërtet se ky vendim është propozua prej Drejtorisë Urbanizmit, për shkak te projektit të rëndësishëm, kemi menduar që do të kaloj por ministria e ka shpall aktin të paligjshëm por deshta me Agimin nuk janë bërë dame asgjë nuk është zbatua, gjatë diskutimit Agim sikur vendimi u zbatua dhe u bë dëmi veç këta deshta me theksua se tek e fundit ato e kanë këtë punë.

z. Agim Çaka: Po me vjen keq qe për këto tema shpesh herë gati thuaj se në çdo seancë po duhet me i diskutua për njëjtën problematikë e cila po na vjen për njëjtën çështje. Unë kisha dashtë prej administratës, qe gjate seancës tjetër me najë sjell d.m.th. numrin e gjitha vendimeve që i kemi marrë si Kuvend, sa është numri i atyre vendimeve për ndërrim destinimit qe najë ka kthyer ministria, mu po më intereson formalisht sa janë vetë fakti si nivel duhet me pyet dikën tjetër a e kemi marr një vendim në përputhje me ligjin, kjo tregon qe ti nuk ke fuqi me i krye punë qytetarit pa e pyetur dikën tjetër, fatkeqësia është qe me vetëdije shpesh po e themi që po e dimë qe jemi keq hajt po qojmë se ndoshta bëhet kështu, nuk është mirë me marrë vendime tu e ditë qe me vetëdije nuk janë përputhje me ligjin, mendoj se secila komunë ka zyre ligjore Kryesues nuk është përgjegjësia e asamblistëve, sa është e zyrës ligjore.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përketë propozimeve as zyra e Kuvendit nuk bën propozime për Kuvend por bëjnë drejtorit përkatëse të cilët e kanë stafin profesionalë dhe ligjor. Drejtorit bëjnë propozime për Kuvend dhe sigurisht i kontaktojnë zyrtarët ligjor. Sa i përketë asaj se sa vendime i kemi marr, sa na kanë kthye dhe sa kanë kaluar ato i sjellin pa problem se janë. Mund them qe jemi një ndër komunat më të mirat në këtë drejtim se është edhe raporti vjetor i funksionimit Kuvendeve Komunale, do te ju sjelli edhe atë, është edhe raporti gjashtë mujore dhe vjetor dhe aty e shihni se sa vendime kundërligjshme i kemi marrë e qe najë kanë kthyer dhe sa vendime komunat tjera qe javë kanë kthye e si kanë rishqyrtuar hiç. Përgjegjësia penale absolutisht nuk kalon te anëtarët e Kuvendit, ne jemi staf politik ne mundemi me diskutua për një vendim a është i mirë apo i dëmshëm apo i suksesshëm ligjin na nuk e njohim në momentin qe ja nisem me interpretua ligjin mes vete ne gabojmë rend se asnjë nuk e interpretojmë njësoj pasi qe edhe nuk jemi profesionist të fushës.

z. Agim Mani: Fjala ime e mëparshëm qe ke shumë i bazuar dhe i argumentuar pa përdor politik edhe pse jam përfaqësues politik i një grupi mirëpo po me duket qe ti kryesues po e luan edhe rolin ekzekutivit ose po mendon me devijua debatin, ti vet e thave qe po banë politik kjo nuk është politik, politik bëni ju ti me vetëdije të plotë ju thatë qe ki vendim nuk kalon edhe e keni prur në Kuvend i keni manipulua gjithë anëtarët e Kuvendit. Të gjithë ato anëtarë të cilët kanë votuar në këtë pikë të rendit ditës sot kanë me votua kundër vendimit qe kanë marrë vetë të gjithë kanë me votua. Problemi tjetër në kësi raste ju e dini qe me këto vendime është ndërtuar dhe i ka mbet biznesi në gjysmë këtij drejtimi. shkoni shikoni në Ivajë me kësi vendimi mbasi kanë filluar punimet i keni prur në Kuvend komunal për ridestinim të tokës nuk ka kalua, punimi është në gjysmë çka me i bë aty investitori. Kryesues a e din qe kur e ke shfuqizua vendimi punimet janë kanë procedurë e sipër prandaj ne po kërkojmë qe fillimisht krijohen baza ligjore që të mos me i pengu, investitori veç kështu i ndihmojmë. Kryesuesi qe tha politike po këqyr me hekë barrën nga vetja dhe me ja qit ministrisë. Investitorin duhet me orientua mënyrë profesionale me i dhanë këshilla profesionale me ja tregu rrugën se si duhet filluar mënyrë institucionale për me bë një biznes tillë kjo është rruga.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë jam prej 2009 në Kuvend Komunal, kam bërë politik sa kam mundur. Këto çështje qe na i diskutojmë dhe qe ti na thua që shkelim ligjin fatmirësisht është çështja te ndërrim destinimi i tokave, ne i kemi edhe katër vendime tjera këtu po kanë kërkuar me u ndryshua plotësua për shkak disa gabimeve, ata qe ju ka marr mendja qe janë ato nuk kanë me u shfuqizua kanë me u vendos prapë por me përmirësime qe i kanë dërguar ata. Çështja problematike e vendimeve komunale, jo veç i joni por te të gjitha vendimeve komunale është ndërrimi i destinimit tokave për shkak të mungesës së Planit Zhvillimorë Komunal.

Plani Zhvillimore Komunale është një dokument, te cili e miraton Kuvendi Komunal, i cili behet nga ekspert por e miraton Kuvendi Komunal në aspektin ligjore te përgjithshëm. Çdo dokument që e miraton një institucion, mundet ta plotësoj dhe ta ndryshon po i njëjti institucion, kjo logjik ka funksionuar edhe përpara ku ka pasur plot vendime të Kuvendit Komunal, edhe këta që jemi që na ja kemi ndërruar destinimin prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore edhe pse nuk ka fillua PZHK-ja, me vendim të Kuvendit edhe ta ka kthye te ligjshme, besoni që ka edhe këso lloj te vendimeve. Sidoqoftë na gjithmonë jemi nis për një periudhë 10 vjeçare, sepse nuk pasur mundesi , çdo gjë me përpikmeri sot ke me be PZHK-në të ri komunal, sot ke me miratua mos mendo që për 10 vite kemi me ja qëlluar me këtë plan mbas 5 vite ka me u paraqit një nevojë qoftë për me ndertu një institucion qoftë për me pru një investitor që ndoshta na duhet me ndërhy atë plan tash nuk mundet me mbet peng por ka qenë e arsyeshme sipas ligjit deri në 10% të PZHK-së, me pas mundësi me u rishqyrtuar edhe në fazat në vazhdim këto çështje nuk janë ka ndodhin dy vitet e fundit nuk na kanë lejuar më me bë ndërrim destinimin me vendim Kuvendit qysh i kemi bërë më herët edhe brenda kësaj qeverie kemi bë por tash dy vitet e fundit nuk janë ka lajnë për mendimin tim e kanë bazën se e kanë PZHK-në por e kanë edhe mundësin tjetër me i lejua këto ndërrim destinime kur është arsyeshmëria për shkak të investimeve apo për shkak të një urgjence, për të mirën e një institucionit. Autostrada nuk është e paraparë me Planin Zhvillimore Komunal të Kaçanikut nuk është por është maru nuk të ka vetë kërkush pse e shkelen ligjin ata. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 16 votë Për, Kundër 6 nga LVV. Prezentë 22. Nuk janë: Betim Shala, Arta Avdiu, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Burim Shehu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Shfuqizimin e Vendimit 01Nr. 06-350/02-11622/24 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore, ZK Elezaj, në emër të "Migros Group", me përfaqësues Mustafë Rexhepi;

5. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-12092/24, të datës 31.05.2024, për Bartjen e Mjeteve nga Rezerva Komunale sipas Buxhetit të vitit 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Përshëndetje gjithëve, fillimisht faleminderit që i keni trajtuar këto pika në seancën e kaluar dhe i keni aprovua, por na vjen keq që me të vërtetë sepse ju ngutem për këtë seancë, kemi qenë të vetëdijshëm që mbahet seanca e rregullt, për të cilën miratohet buxheti i vitit 2025 dhe vlerësimet 2026, 2027, por na kemi kërkuar nga kryesuesi që kjo të mbahet sa ma shpejt meqenëse nuk ka nevojë me ju nënshtrua procedurave të KPF-së, meqë janë plotësim ndryshimi por këto kanë rrjedh për shkak vonesës të aprovimit të shqyrtimit nga ministria e financave, kur filluan me i shqyrtu na ka dhanë disa vërejtje të cilat disa i kam pranua dhe janë vërejtje teknike por që duhet me i respektu nuk me i kanë kaluar, ka pas raste herën e kaluar herave tjera për një shkronjë për një emërtim të një projektit kanë pas mirëkuptim kur e kanë kërku sqarime shtesë analiza e kanë vërtetu që është një lëshim gabim teknik dhe i kanë kalu edhe ministria, kësaj here nuk i kanë kalu asnjë për shkak se te secili vendim nga një gjetje e vogël dhe kjo ka rrjedh për shkak të bartjeve të mjeteve që janë bë kryesisht që janë disa bartje po flas përgjithësi jo veç për këtë vendim kur janë bart kanë qenë në vitin e kaluar kur kanë mbet pa shpenzu , ndërsa këtë vitin që kemi hi i aktualisht ekziston i njëjti projekt por me ndonjë ndryshim të vogël dhe tash na i kem dërguar ashtu dhe jemi pajtu edhe ata d.m.th. kanë thënë kështu bëni dh jemi pajtuar me i respektua rregullat qysh i kanë kërkuata nuk ka najë ndryshim drastik te këto vendime.

Te rezervat komunal nuk është ajo rezervë që e kemi lënë për një rast emergjent por është rezervë komunale 25,000.00 € , me lanë ashtu mbetet e pa shpenzume mbetja kryesore ka qenë për shembull më herët që është propozua bartja për tejkalimin e të hyrave 230,000.00 €, në atë vendim 230,000.00 €, ka qenë një projekt e kemi pas bërë një kërkesë me hap një projekt ndërtimit i trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën "Fadil Bunjaku" Biçec, atëherë nuk ka pas kod d.m.th. kemi kërkuar me hap të ri ndërkohe kur ka shku kjo e dyta për këtë shkresën më kanë thënë pse nuk e ke shkruar numrin e kodit, ama ajo ndërkohë ka marr kod por na kur e kemi propozua dhe ju kur e keni miratua nuk ka pas kod. Ndërsa në propozimin e ri që kam bërë e kam shkrua kodin mundeni me vërejt në atë vendimin e kalum thotë ky projekt që përmendet projekt i ri unë që e kam shkrua projekt i ri që nuk ka pas kurrë mirëpo tash përmendet i njëjti projekt po thotë kod 55191, sepse ka marr kod nga ministria dhe tani këtu për shkak disa rrjedhave ndryshimeve që kanë ndodh në realizim të projektit këtu kam kërkuar 19,400.00 €, por tash i kam kërkuar 20,000.00 € d.m.th. 600.00€ më shumë. Kisha pas qef me diskutua edhe për raportin gjashtëmujor sepse nuk kam qenë në seancën e kalume që është ngrit një shqetësim tepër i madh për qatë bartjen nga Agimi dhe Kadrija se i kam lexuar në procesverbal është vonua bartja për shkak këtyre gjerave ndodhin edhe këto ndryshime. Te njëri prej vendimeve për rialokimin e mjeteve nga fondi 22, që kemi thënë unë e kam shkruar ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve të fshatrave Llanisht, Nikocë, Korbliç Drenogllavë, te e dit na terrenin siç e kemi ndërsa këto thojn heke dhe të mbetet emërtimi ndërtimi i rrugës dhe asfaltimi i fshatrave Llanisht, Nikocë, Korbliç d.m.th. veç fjala Drenogllavë, hiqet po ashtu është kanë rregullimi e kemi shkruar ndërtimi d.m.th. për këto gabime teknike janë kthyer unë mundem me jua dërgua emalin e ministrisë që më i kanë dërgua emal zyrtar kur kemi komunikuar për këta lëshime qoftë nga ana jonë qoftë nga ana e tyre. Mjetet që po i heqim prej parkingut nëntokësorë fillim e keni aprovua qatë propozim vendimin për shkak se nuk kanë qenë tll shpenzume asnjë mjet as një shumë të projekti i parkingut nëntokësorë tash, ndërkohë një lëndë gjyqësore përmbartimore te i njëjti projekt najë ka tërhequr shumën diku 43,000.00 €, për një lëndë përmbartimore gjyqësore që nuk na pyesin i kanë tërheq ata d.m.th. ka ndryshua hesapi unë i kam dërgu propozimin kanë qenë parapame me u minisu ato mjete me u hekë e me shku dikun tjetër tash nuk vlen më ajo kërkesë d.m.th. te secili vendim më kanë gjetë diçka që duhet me u ndryshua. Ju falënderoj që keni votua, ju kemi mundu këtë seancë më herët por veç se jemi afër fund vitit por kërkoja nga këta që me mirëkuptim të mbajmë këtë seancë më herët sepse jem fund vitit edhe kjo ka të bëjë me ekzekutim sa më të lartë të buxhetit

z. Rrustem Zenuni: Seancën e kalume kemi pasur një shqetësim nga kolegët për 230,000.00€, që janë avullua a mundesh me na tregu drejtor ku kanë mbete ?

z. Bahri Selimi: Te raporti gjashtë mujorë është ngrit dilema, pse kanë figurua veç 867,857.00 €, të hyra të bartur nga vitet e kalume në vitin 2024, arsyeja është që jau kam dërgua edhe me shkrim, e kam edhe me vete dokumentin e ministrisë, me numër protokolli, me datë kur janë aloku ato mjete kur janë transferua kur janë realizua në buxhetin e komunës tonë është data 16.07.2024, ndërsa raporti gjashtë mujorë ka pas të bëj me çdo hyrje dhe dalje te parave publike, deri me datën 30 qershor ashtu bëhet raporti dhe nuk guxojmë aty asgjë me shënuar të një korrikut nëse ka ndodh një ngjarje një pagesë ose janë realizu 100,000.00€, të hyra që kisha muajt me u lavdu me ato të hyra por nuk guxojmë me i paraqit në raport por me prerje deri me 30 qershor, pra kjo është arsyeja. Shuma tjetër 230,210.00 €, është bart mbas datës së raportimit d.m.th. mbas datës 30 qershor seanca është mbajt në korrik por raporti dorëzohet me prerje.

z. Agim Mani: 230,000.00 €, nuk janë bart komplet te 230,000.00, janë bart nëpër kode buxhetore.

z. Bahri Selimi: Agim janë bart me datë 16 korrik është aprovua nga ministri z.Hekuran Murati.

z. Agim Mani: Kjo pikë që është sjell në Kuvend për plotësim ndryshim të vendimit. Një vendim që ju e keni marr më herët, duhet me plotësua na për shkak mangësive apo keq planifikimit juve që keni pas është vendim me numer 01Nr.400/01-12092/24, ky vendim është marr me datë 31/05/2024, që ka të bëjë me bartjen e mjeteve nga rezervat komunale nuk është logjike të bëhet një plotësim vendim pa e shfuqizu vendimin paraprak, ai ka qenë vendim duhet me shfuqizu vendimin paraprak dhe të diskutojmë për vendimin që është aktual tash.

Për këtë arsye kërkojmë nga ekzekutivi që të na njoftoj me shkrim një gjë tillë që nuk e marrim cila është shqetësim nëse e ka dërgu në MAPL drejtori cila është përgjigja e ministrisë e MAPL-së, nuk ka përgjigje e kërkojmë cila është apo nëse ky propozim vendim nuk është vepruar fare atëherë cili është ndryshimi që ju e keni bërë a e keni pasur mirë atëherë apo e keni sot këtu kërkojmë të kemi sqarim se 25,000.00 €, rezervë ndoshta është mirë të i leni rezervë edhe 100,000.00 €, por ti orientoni ka të doni sepse e keni mundësin ma të lehtë.

Sa janë këto mjete që duhet të i rialokoni, rialokoheni në ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimin në rrugën "Fadil Bunjaku" Biçec, sa i keni zotu në këtë projekt dhe a e dini që ky projekt është në procedura prokurimit kanë fillu procedurat për këtë projekt a i ke mjetet e zotume nëse i ke hap procedurat e tenderimit.

z. Bahri Selimi: Nuk jam prokurim unë, na jemi ato që ja kryem punën njerëzve kur nuk kemi pasur mjete në vitin e kalum, këtë vit ja kryem punën se ti 25,000.00 €, i kishe lanë pa i shfrytëzu. Agim na realizojmë investime, kemi ndërtuar edhe shkolla që është kanë obligim i ministrisë. A e dini çfarë obligime të ministrisë i kryem jemi duke e ndërtuar trotuarin në Fushë Pajtimit është projekt i ministrisë.

z. Agim Mani: Drejtor, sa mjete i keni të zotume në këtë projekt që po doni me ja dhënë edhe 20,000.00 €.

z. Bahri Selimi: Ky projekt nuk bëhet me 20,000.00 €, është projekt dy vjeçar.

z. Agim Mani: A i keni zotu 100,000.00 € ?

z. Bahri Selimi: A e kemi kalu seancën e muajit maj nuk është krye hala përpara u kryheshin sepse punojke ministria, punojshin zyrtarët a e dini çka ndodh me administratën publike total kolaps është secilin dikaster qytetari këtë nuk e sheh, këto banorët e Biçecit që nuk po ju ndërtohet trotuari i ka fajet dikush a e dini që shteti nuk ndërtohet duke menduar negativisht por duhet me menduar pozitivisht. Në muajin Maj e kemi dërgu kërkesën normal që zyrës së prokurimit i ka shku kërkesa nga njësia që është Drejtorja e Shërbimeve Publike i ka shkuar kërkesa me u realizuar ky projekt tash ka ngec, kush e ka ditë a na e kemi ditë që kjo nuk po e lenë për një ndryshim të vogël që përpara na kryheshin në dorë se kanë bërë analizë, lypshin ndonjë dokument shtesë një kontratë, një dokument keni kërkuar diçka të ligjshme është buxheti juve këtë buxhet e ka miratua Kuvendi komunale kjo është burokraci lëvizja e mjeteve në këtë mënyrë.

Kryesuesi i Kuvendit: Ky plotësim ndryshim nuk ka ardhur nga MAPL-ja, është dërgua në MAPL nuk është shqyrtua hala në MAPL, paralelisht obligimit për me i dërgua vendimet në MAPL e kemi na Kuvendi na i dërgojmë MAPL vendimet, paralelisht me vendimet tona që i dërgojmë Kuvend çka kanë të bëjnë me financa drejtori i dërgon edhe në ministri financave sepse edhe MAPL-ja ka me qenë e detyrueshme me i dërgu ministri financave, drejtori gjatë komunikimeve me ministrin e financave që i kanë parë këto ngecje në këto vendime ministria i ka sugjerua drejtorit që të i përmisoj, në këto pozita ku duhet edhe të jemi në rregull me

vendimet pastaj për mos me humb kohë në bartje këtyre mjeteve për shkak se MAPL-ja, e ka afatin ligjor 15 ditë deri sa ti dërgon ministri financave e MAPL-ja me i kthye komunë afati kohorë ka qenë ma i gjatë nëse ish trajtu këtë formë fatmirësisht ministria financave i ka kthye drejtorit me njëherë sepse këta e kanë vijën drekët që komunikojnë, eshë marr masa për me u rregullu këta vendime e jo mu shfuqizu.

Agim qysh po e kërkon ti sepse kërkush nuk ka kërkua me shfuqizua vendimin kanë kërkua me plotësu dhe ndryshu dhe kjo natyra ligjore e njeh këtë formë.

z. Agim Mani: Kush e ka kërkua, ku është dëshmia?

Bahri Selimi: Është në email dëshmia, ua dërgoj të gjithëve në email.

Kryesuesi i Kuvendit: Agim jemi të obligum me sjell vlerësimin ligjor të MAPL-së në Kuvend vija zyrtare interne qe komunikojnë drejtorit me ministrit nuk janë për Kuvend, shqyrtimi ligjor i MAPL-së e kanë obligim ligjor me sjell nëse është keq.

z. Agim Mani: Kryesues cili është ndryshimi me vendimin paraprak.

Kryesuesi i Kuvendit: E sqaron drejtori.

z. Agim Mani: Pasi që më mbet fjala në gjysmë kisha lutur drejtorin që ta ul tensionin dhe me gjak ftohësi kuptohemi më lehtë, sepse çdo gjë kemi përpara dhe çdo gje duhet me diskutua dhe argumentua edhe arrijm deri me një konkludim.

Pyetja ime ke shumë e thjesht, sa mjete keni ndarë për ndërtimin e trotuarit dhe ndriçimit publik në rrugën "Fadil Bunjaku", a i keni të zotuar 100,000.00 €, apo nuk i keni? Nëse nuk i keni, atëherë si keni fillua me procedurat e tenderimit pa i pasur mjetet e zotume?

100,000.00 € janë zotume nga ekzekutivi dhe janë hap procedurat e tenderimit hala ky projekt është në proces mirëpo këtu po i bien që 100,000.00 €, nuk janë zotume ju po thoni me i shtua mjete tjera kjo është e pa logjikshme dhe e pa ligjshme sepse kur të hapen procedurat e tenderimit mjetet duhet me kanë të gatshme zotume. Kryesues mbasi ti po do me fol, sa mjete janë zotume te ky projekt.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk e di për shifra e për mjete, por po të them qe zyra e prokurimit pa i pas mjetet e zotume nuk guxon me lidh kontratë nëse ti e di qe u lidh kontrata urdhno.

z. Agim Mani: A i ka të zotume 100,000.00 €.

Kryesuesi i Kuvendit: Me siguri duhet me i pas.

z. Agim Mani: E pse po i bart këto mjete.

Kryesuesi i Kuvendit: Po është projekt dy vjeçar.

z. Agim Mani: Kryesues ti këto mjete a je tu i bart për me i realizua për vitin 2025, kjo nuk është etike këta po e kërkoj unë.

z. Naim Beça: Agim shumë qartë po thotë nëse nuk janë 100,000.00 € dhe tash po do bartje për 2025 këto para keni me thënë i kemi bart prapë.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë një gjë e di që sipas ligjit prokurimit nuk guxon me thanë qe nuk i ke mjetet.

Nënkryetari i Komunës: Vendimi në projektin në fjalë qe po pyet Agimi, a janë zotume 100,000.00 € dhe qysh të njëjtën kohen janë tu hec procedurat e prokurimit, jo veç na por secilën komunë ka projekte që hecin procedurat e qe janë projekte dy vjeçare ose tri vjeçare e

që prej prokurimit kërkohet disponueshmëri të mjeteve, për shembull sa janë këtë vit dhe sa janë vitin tjetër, nëse nuk guxon me shkel ligjin e prokurimit se nuk mundet me lidh kontratën nëse është dy vjeçare. Ndoshta për shembull mundet me kanë 20,000.00 €, për këtë vit apo 30,000.00 € varësisht prej financave se sa e laboron, 70,000.00 € mbesin për pjesën tjetër por ashtu lidhet kontrata, kur të lidhet kontrata prej prokurimit që bëhet dy vjeçar disponueshmëria e mjeteve është për këtë vit 30,000.00 € për vitin tjetër është 70,000.00 € dhe nuk ka shkelje të ligjit.

z. Agim Mani: A duhet me pas ato mjete zotume ?

Nënkryetari i Komunës: Nëse është dy vjeçar me at disponueshmëri mjeteve që e bën dy vjeçare por nëse është prej tani me i pas te zotume për vitin tjetër, na po të thojmë që 100,000.00 € nuk i kemi zotume sikur për shembull si mundem me akceptu që buxheti në nivelin Kosovës janë dhënë 200,000.00 € për shkollën "Emin Duraku" dhe Gjilan dy shkolla. Ne e dimë që me 200,000.00 €, nuk ndërtohet shkolla "Emin Duraku", ndërsa thuhet kanë me hec te gjitha procedurat, por procedurat ligjore që e mbush atë fond edhe na nëse ka gjatë procedurat shkelje të ligjit Agim lirisht denoncon.

z. Agim Mani: Unë kërkova sqarim a janë të zotume 100,000.00 €, ju po thoni nuk janë atëherë keni bërë gabim që keni hap procedurat e tenderimit pa i pas mjetet e zotume d.m.th. kjo është gabim.

Nënkryetari i Komunës: Është dikush tjetër që e vlerëson a është gabim apo jo, sepse shumë shpesh keni thënë është gabim por nuk ka dal ajo çfarë ke thënë.

z. Agim Mani: Edhe ju keni thënë që ky vendim është mirë, por tash nuk është mirë sepse po duhet me plotësu. Për këtë propozim Vendimin e keni votu që është mirë më herët, por tani po bindeni që na e kemi pas mirë, ndërsa ju nuk e keni pas mirë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pse a keni thënë ju atëherë që duhet me i shtu 25,000.00 €, ju keni thanë gjithmonë keq është.

z. Bahri Selimi: Këto mjete që janë parapame për dy vjet, ligji dhe sistemi aktual që është i financave që menaxhohet prej ministrisë financave, nuk lejon zotim dy vjeçar dhe na veç planifikim kemi për vitin e ardhshëm edhe me dashtë teknikisht nuk realizohet zotimi dy vjeçar, sepse vërtet është në kuadër të reformës së financave publike që ka me u ndryshua ky lloj sistemi, nëse komunat ose ministrit planifikojnë për tri vjet me mund me u bë zotimi për tri vite i planifikimit, aktualisht ju garantoj se qysh funksionon tash për tash sistemi financiar në Kosovë dhe në bazë sistemit publik mundesh me zotu mjete veç ato të cilat i ki disponuesheme. Në këta e kemi filluar në muajin Maj por na ka dështua dhe nuk është realizu d.m.th. na ka kthyer ministria, por të ishin kur e keni aprovu në muajin Maj e të ishin realizu nga ministria ato mjete do të kishim të zotume ndërsa përgjigjja lidhur me pyetjen konkrete është që këto mjete 20,000.00 € nuk i kemi te zotume, gjë te cilën edhe nënkryetari e laboroi shume mire.

z. Agim Mani: E para punës kisha dashtë që mënyra e debatimit mos me kalu personale, por pajtohuni gjithmonë me faktin që na mundemi mos me i pas te qarta këto gjëra që po i diskutojmë, pajtohuni që mënyrën e funksionimit te ministrisë financave nuk mundemi me pas te qartë siç e ka drejtori, ata çka po e shoh këtu qasje që e kam për këtë temë kishte me ndryshua me pas qenë propozim vendim për shqyrtim ose rikthim të këtij vendimit apo

shfuqizim të vendimit. Nëse na kish dergu ministria se ky vendim duhet me u shfuqizu, e ju shqyrtone këtë far pune atëherë unë kisha pas qasje krejt tjetër në debat, por kur e shoh këtu

propozim për plotësim ndryshim, kjo domethënë që në esencë vendimi nuk ka najë far problemi të madh me ligjin por i ka do çështje siç e tha drejtori janë do çështje teknike që nuk janë të pa rëndësishme, por janë që nuk ke qare pa i bë për shkak se ti je i varur prej tij dhe ai thotë duhesh me i bë fundi është që ti me hec përpara me vendim kështu që nuk e di unë çka ka nevojë me hi debate e me u zgjat debati, është bë emërtimi por qartësimi duhet me u bë me ditë qartë asambleisti se çka është po behet me këtë vendim.

Është vendim që e kemi marr ma herët dhe çdo vendim kalon në shqyrtim të ligjshmërisë në MAPL. MAPL-ja kalon varësisht se ku shpesh herë po i dërgon te Ministria e Bujqësisë për me bë nderim destinimin pastaj ministra bujqësisë po i thotë MAPL-së, këtu nuk bën se ka shkelje ligjit, në këtë rast kjo ka shku në ministrin e financave dhe këto janë koordinua për ketë arsye. Unë e kam të qartë këtë far pune, unë kam votu njëherë por nëse duhet me bë këtë plotësim ndryshime duhet me bë dhe me hec me punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me 15 votë Për, Kundër 6, Abstenim 1. Prezent 22. Nuk janë Betim Shala, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Arta Avdiu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-12092/24, të datës 31.05.2024, për Bartjen e Mjeteve nga Rezerva Komunale sipas Buxhetit të vitit 2024.

6. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-11717/24, të datës 31.05.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore nga Burimi i Fondeve 22 - Të Hyrat e Bartura nga Viti i Kaluar 2023 në Buxhetin e vitit 2024;

z. Bahri Selimi: E thash edhe me herët kjo ka të bëj me disa ndryshime në emërtimin e projekteve, kur isha duke i dhënë përgjigje Arlindës e njëjta vlen e kam përmend te pika 1 edhe më herët, këtu ka qenë Drenogllavë, këtu është hekë veç fjala Drenogllavë nuk ka diçka tjetër. Këtu çka është përmirësuar është thjeshtua ky vendim kemi pas të parapame me i transferua nga shërbimet sociale pra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, një shumë prej 5000,00 €, e cila është bart në mënyrë automatike nga viti i kalum në këtë vit dhe nëse rrinë ashtu nuk i hyn kërkujt dhe mbetet e pashpenzuar, na me qellim që me i shpenzua kemi dashtë me i qit te objekti për banim social i cili po ndërtohet këtë vit. Nuk është që kemi pas me bë najë gjë me atë shumë por veç mos me lënë pasive me kalu në buxhet të këtij vitit nëse ka nevojë ai projekt me financu dhe ka nevojë mirëpo, për me mu thjeshtua sa më shumë për me kalu këto tjerat mos me mbet pezull, këta e kam hekë mundemi nëse është bash patjetër me një propozim vendim të ardhshëm, nuk ka ndryshim edhe më herët thash ku punohet gabohet. Unë ne vend se të shkruaj rregullimi i kanalizimit në fshatin Begracë, në vend të fjalës rregullim e kam shkruar ndërtim, tash në këtë propozim e kenë rregullimin e kanalizimit në fshatin Begracë ne shume prej 21,698.00 € dmth e njëjta shumë, është, nuk kemi të bëjmë me ndryshim të shumës por veç tek fjala rregullim. Më herët nuk mi kanë kthye për një detaj të vogël.

z. Agim Mani: Ky propozim vendim i kësaj pike vjen si pasoj e mos realizimit të këtyre mjeteve, dhe shqetësimet që janë shfaqur pas miratimeve të vendimit të mëparshëm i cili është miratua tre muaj më parë d.m.th. ky vendim që e kanë votu tre muaj me parë dhe nuk është realizuar, pra mjetet që ishin të parashikuar të realizohen viti 2023, nuk janë realizu këto mjete edhe pse ishin të planifikuar barten për vitin 2024, dhe prapë në mungesë të vizionit apo të plani të ekzekutivit këta mjete fillimisht barten në vitin 2024, kodohen nëpër kode të ndryshme dhe kërkohet prapë të barten dikun tjetër i cili vetë ekzekutivi i kodoj a tash

kërkohen që këto mjete të rialokohen kinse për realizimin dhe bartjen kod pas kodit dhe ekzekutivi d.m.th. i bart kode të ndryshme këta mjete.

Unë mendoj që ka hapsir të madhe për shqetësimin edhe të ato mjete sepse këtu ka keq planifikim ekzekutiv, ekzekutivi nuk ka ofruar një plan të detajuar për zbatimin e këtyre mjeteve ka përdorur kode buxhetore të ndryshme duke realizuar në një rialokim për projekte tjera. Ky ndryshim ka ndodhur pas një shqyrtimit të mjaftueshëm të zbatueshmërisë dhe ne besojmë që kjo qasje do të qoj në vones edhe tek këtyre majtëve të cilat kanë qenë tash këto mjete po rialokohen po e marr shembull të rruga "Idriz Seferi" 5,000.00 €. Unë kisha dashtë një sqarim qysh ka me muajt me realizu 5,000.00 €, të rruga "Idriz Seferi" ku e dini që aktualisht ajo rrugë është rrugë alternative për shkak mbylljes së magjistrale që e lidh Shkupin dhe a keni me nda këtë rrugë për me i realizu punimet apo qysh keni me muajt me i realizu apo nuk keni me i realizu hiç dhe keni me i bart prapë.

Shqetësim tjetër është rregullimi i sheshit të qytetit, faza e parë ndahen 17,000.00 €, por për fazën e parë kur e dimë që sheshi i qytetit ka përfunduar është përrurua dhe ju prapë e keni kthyer në fazën e parë. Kjo është jo e logjikshme se çka bëni ju, ndryshe planifikoni, ndryshe veproni të këto mjetet prapë nuk keni me i realizu ose jepni sheshit qytetit një aneks projekt domethënë kjo është keqpërdorim i parës qytetarëve, duhet të bindeni njëherë këto para janë qytetarëve nëse mundeni me na dhënë përgjigje cilën fazë punimeve është sheshi i qytetit tash.

z. Bahri Selimi: Është në fazën finale.

z. Agim Mani: A është në fazën finale pse po i ndani parat për fazën e parë, është mirë që ky projekt është në fazën finale dhe i keni nda 17,000.00 € për fazën fillestare kjo është e pakuptimtë se qysh veproni ju, faza fillestare projekti qysh e dimë na kryhet me faza përfundon faza e parë jepet një pjesë e mjeteve vazhdon faza e dytë dhe faza finale nëse ka devijim të projektit mundesh me marr edhe aneks projekt se e lejon ligji ama jo të kthemi në fazën e parë ky është keq planifikim dhe keq menaxhim i projekteve të cilat po i bëni ju, po këto para nuk keni faj se nuk janë të juve po janë të qytetarëve dhe i ndani i rialokoni ka të doni ju.

z. Bahri Selimi: Përbesë nuk e di sa është e drejt me u malltretu këto tjerët dhe na me i dhanë përgjigje atyre që është propozuar herën e parë është bojkotua që the edhe ti Kryesues kurrë nuk kanë votu pro një ndryshimi, pa marr parasysht çfarë partie subjekti ama kurrë nuk e kanë analizuar se ku po shkojnë ato mjete këta më shumë analizojnë ku po i minusojm mjetet dhe ku po i heqim mjetet ndërsa nuk ua nin se ku jemi duke i dërgua mjetet, më shumë duhet me ju interesu ku jemi tu i dërgu mjetet dhe përgjigjen ta jep drejtori se krejt kanë të bëjnë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Në si financa nuk është e vërtetë që i kemi kodua më herët këto që po i heqim por i ka kodua ministria e financave hera parë se kështu kanë ndryshua rregullat nuk kanë qenë më herët këto rregulla kur ka qenë ministër i financave Bedri Hamza, Avdullah Hoti e Hykemet Bajrami nuk ka pasur kesi rregulla e kanë pyet komunën asambleenë mjetet e shfrytëzime paraprake i nderuar Kryesues ku po donë me i dërgu sepse kanë mbete të pa shpenzume normalisht që të vyen me i shpenzua për vitin vijues, të ka pyet na nuk ja prumë atë propozim vendim është hera parë prej se ka lind ky shtet që ndihet edhe ndërkombëtarisht dhe prej masë lufte hera parë kështu kanë vendos me punu, kjo është bojkotim e ashtu bojkotimin po e rrjedhin këtu nuk najë keni votu që po lypni kaq shumë arsye. Unë çdo herë kur jap arsye më shumë për shkak këtyre që e kanë votu asnjëherë për juve.

Kodet kanë dal në mënyrë automatike janë kodua janë bart të hyrat e pa shpenzuara nga viti 2023, në vitin 2024 në mënyrë automatike pyetni edhe ministri apo ku të doni, po ti lë ashtu mbeten të pa shpenzuara ndërsa secili drejtor e ka përgjegjësin me thanë se këto mjete që po

mbeten të pa shpenzuara që janë bart në mënyrë automatike që nuk na pyet ministria janë bart edhe projekte të cilat janë përfundua dhe nuk ekzistojnë lista tona të planifikimit buxhetor të tri viteve të ardhshme nuk ekzistojnë qysh me i lënë ato kënde.

Agimi thotë është para publike nuk është para e juve por paranë publike duhet me menaxhu me shti në shfrytëzim dikush përfiton, përfiton i fundit qytetari e jo ti lënë pasive na nuk punojmë me këtë metodën ti lënë buxhetin e shtetit ose komunal pasiv na e shtim shfrytëzim jo rastësisht janë ndërtua këto autostrada këto rrugë lokale etj.

z. Ramadan Osmani: Sinqerisht për Agimin mundem me thanë lirisht le ta shikon ingjizmini e seancës kur është votu ky vendim. Të njëjtën pyetje e ke bë për rrugën "Idriz Seferin" dhe e ke marr përgjigjen dhe interesant të njëjtën pyetje po e banë dhe tash prapë, po ta jep përgjigjen, këto para të rrugës "Idriz Seferit", jam tu kërkua me plotësu buxhetin sepse kam sinjale nga terreni që dalin punë të pa planifikuar që duhet me lidh anex kontratë për me lidh anex kontratë, nevojiten me shtu buxhetin. Edhe një detal tjetër që ju nuk e dini na jemi detyru me shti funksion ketë rrugë para se me u pranua teknikisht, shkak i specifikave të hekurudhës. Por ju nuk e dini që kemi marrëveshje me kompaninë Italiane, që janë financon edhe një shtresë tjetër, veç se e kemi leshu para kohe, jashtë këtij buxheti e kemi përfitua sepse nuk kemi muajt me i thanë kompanisë, me u fut në shfrytëzim para se me u pranua teknikisht por është garanc, që do të shtrohet edhe një shtresë tjetër sheshi ka anex kontratë edhe është në fazën finale. Pjesa e kontratës bazë kështu që me këto mjete e plotësoj nevojën me pagua anex kontratën edhe pjesë të mbetura edhe detali tjetër që nuk e dini është pranua teknikisht kanalizimi në fshatin Begracë sipas kontratës e kam situacionin tu prit për pages me nevojiten, që ky alokim i mjeteve me ja krye pagesën për arsye se ne hecim me hapa kontratës tu e ditë që para tre muaji vendimi është marr për alokim të këtyre mjeteve.

znj. Ardita Rrahmani: Na këtë debat pikërisht për këto pika në seancën e kalume e kemi shtjerr kemi diksutu kush ka qenë e dini, kush nuk ka qenë mandej po detyrohen të tjerët me i dëgjua fakt ato që njëherë janë diskutu. Po e ritheksoj edhe njëherë fillim të mandatit e kam bë pyetjen, se nuk e kam ditë kamë thënë pse gjithë ato kode po dalin nëpër buxhet nga 5,000.00 €, edhe përgjigja ka qenë prej drejtorit "po i ndajmë për arsye se në rast se dikujt i teket me i pru do para këtu me investu dhe themi e kemi kodin për qatë tash këta 5,000.00 €, për derisa gjatë këtij vitit nuk ju ka tek ajo, po ju ka tek drejtorit financave nuk po i kthej por po i destinoj dikun tjetër, me i shpenzua dikun tjetër deri këtu po besoj që jemi qartë dhe jemi krejt në rregull.

Po kritik është te ata që nuk e kthejnë koken ka ne me na përkrah dhe kritik është për juve këtu që nuk e ktheni jashtë Kaçanikut, me tërhek investitor për me i realizu këto projekte do të thotë e dy anshme është kritika, për pushtetin për nivelin qendror që nuk ja ndien për Kaçanik dhe kritika tjetër për nivelin lokal që nuk ja ndien për Kaçanik. Me dal jashtë Kaçanikut dhe me shku nja një javë dikun një tur me bë, me than hajde bre se shtegun për biçikleta për Kaçanik e ka Hani Elezit që pesë vjet shtegun e biçikletave e ka kod nga 5,000.00 € tu i bartë, apët kemi me bart, tani i kemi kode të reja. Sot një vit prapë kemi me diskutu jam e bindur që sot një vit kemi me qenë shumë ma të vrazhdë ju si nivel lokal, na si nivel opozitë e nivelit lokal se i këna zgjedhjet këna me rre tavolinën, më shumë mos bre se marre me na dëgju dikush, por jam shumë e sinqertë që nëse isha kanë një qytetare e thjesht edhe e kisha lëshuar seancën e Kuvendit sot hiç ma larg dy minuta kurrë nuk e kisha dëgju më shumë, ndoshta e kisha leshu masë një gjysmë ore mos po thotë edhe janë kush janë gjë hairit diçka, më falni prej secilit që jeni këtu për gjuhen që po e përdori po sinqerisht këto janë pallavra.

z. Naim Beça: Një kritik për drejtorin Bahri pavarësisht a voton kundër apo pro është demokratike çdo shpjegim që e bën nuk e banë për ata që për persona që votojnë pro apo kundër apo edhe abstenojnë ndërsa sa i përket këtyre kodeve që jemi duke i përmend

Lëvizja Vetëvendosje prej ditës parë ju ka kritikuar krijimin e kodeve të pakuptimta tash drejtori Bahri po thotë na i shfrytëzojmë, pse po i bartin, pse po i alokojnë?

z. Agim Mani: Unë gjithmonë po mundohem me nejt temë mirëpo duhet me kuptua secili prezencën e vetë këtu, pyetjet që i bëj unë janë për qytetarët përgjigjet duhet me i dhënë ekzekutivi nëse ky është injorant ndaj asaj që e tha që vetëm ato që votojnë pro jap përgjigje por edhe ata që votojnë kundër e ka obligim mundesh me dhanë përgjigje dhe mundesh edhe mos me dhanë përgjigje, prezenca e jote këtu është me dhanë llogari nëse nuk donë dil jashtë këtu është vendi jonë ti ke ardh te na e jo na te ti. Nëse ky do me dhanë llogari para qytetarëve duhet me dhanë pa i diferencua këshilltarët komunal. Ne jemi përfaqësues ky ka ardh në dhomën tonë kjo është e jona nuk është ekzekutivit, unë kërkova sqarim rreth kësaj pike të rendit ditës tash pavarësisht dikujt mund ti duken pallavra, unë kërkoi sqarim ne si subjekt secili e mbron qëndrimin e vet si subjekt politik unë e mbroj qëndrimin e Lëvizjes Vetëvendosje dhe kërkoi sqarim nuk e di se sa është e kuptueshme që këto mjete të ndahen në fazën e parë të rregullimit të sheshit.

Unë kërkova sqarim drejtori tha që është anex projekt, anex projekti është fazën përfundimtare jo në fazë të parë ky është shqetësimi që ministria mund të ja kthej prapë me ja ndërrua këtë emër. Tjetra rregullimi i kanalizimit në fshatin Begracë është bërë pranimit teknik mjete nuk ju kanë dhënë a the kështu drejtor çka domethënë kjo është bërë pranimit teknik pa ja dhanë mjetet.

z. Ramadush Osmani: Po nuk mundesh me ja dhanë mjetet, pa ta prurë situacionin e fundit nëqoftëse ta ka punu brenda afatit ligjor, unë i bëjë parat dhe ja jap.

z. Agim Mani: Rruga "Idriz Seferi" që e thash unë, drejtori tha që ka një bashkëpunim me një shoqatë Italiane nëse me të vërtet ka ndonjë bashkëpunim që kanë me rregullu rrugën e "Idriz Seferit" pse po shtinë para prapë në ta.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua kjo pikë. Me 16 votë Për, 6 votë Kundër nga LVV. Prezentë 22. Nuk janë: Betim Shala, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Arta Avdiu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

VENDIM

Për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-11717/24, të datës 31.05.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore nga Burimi i Fondeve 22 - Të Hyrat e Bartura nga Viti i Kaluar 2023 në Buxhetin e vitit 2024.

7. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-14274/24, të datës 28.06.2024, për Transferin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024;

z. Agim Mani: Megjithëse edhe ky vendim është i njëjtë sikur vendimet paraprake domethënë mjetet që po rialokohen kanë me shku te ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit të fshatit Biçec d.m.th. njëjtë kanë me shkua edhe këta mjete kjo i bijën që e keni hap një procedurë tenderimit pa pasur mjete fare.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, u shtrua në votim kjo pikë, u miratua me 16 votë Për, 6 votë kundër nga LVV, Prezentë 22. Nuk janë prezent: Betim Shala, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Arta Avdiu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/01-14274/24, të datës 28.06.2024, për Transferin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024.

8. Propozim për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/03-14313/24, të datës 28.06.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024.

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Edhe te kjo pikë e rendit ditës domethënë këto mjete 237,000.00 €, që ka dështua të realizohet projekti i parkingut nëntokësor në komunë tash duhet të rialokohen apo të transferohen në kode të ndryshme apo projekte të ndryshme. Unë e kam një pyetje për drejtorin apo për ekzekutivin kush do qoftë me dhënë përgjigje 31,000.00 € shkojnë për rregullimin e terrenit sportiv në Glloboshic shumë mirë që po bëhet ky projekt Glloboshicë, mirëpo shumë keq që keni fillu projektin e nuk i keni pasur parat, kjo është shqetësuese të na domethënë veç me i mashtrua qytetarët mirëpo ndoshta doket edhe pallavër por me të vërtet donë sqarim kjo a e dini ju që rregullimi i terrenit në fshatin Glloboçicë janë punimet e sipërme tu punu janë kry procedurat e tenderimit dhe nuk ka pas mjete të zotume është nënshkrua kontrata, kur të nënshkruhet kontrata ndash ligjërish ndash qysh do qoftë mjetet duhet me u zotu, ju si ekzekutiv e keni nënshkrua kontratën mirëpo nuk i keni pas mjetet tash po i bartni kjo është shkelje. Kryesues pajtohem me ty kur the më herët kur nënshkruhet kontrata duhet me kanë mjetet e zotume domethënë këto transferet e mjeteve po i qesin në pa parregullsitë apo keq planifikimet që i kanë bë ma herët. Nuk e di sa e dini apo jeni kanë në teren punimet janë duke u zhvillu në Glloboçicë është nënshkruar kontrata mirë që po bëhet por ju nuk i keni pasur mjetet tash po i bartni mjetet kjo është shkelje e dyfishtë.

z. Rrustem Zenuni: Unë e kam thënë në seancën e kalume d.m.th. kur e kam pas raportin e auditorit është bërë praktik e zakonshme rutinë keq planifikim, keq menaxhim, vjen raporti i auditorit krejt zero zero. Pse unë po dua me lidh këta se unë jam i prirë me ju besua institucioneve, jo opinioneve individuale këtu sepse ky nuk është profesionist i çështjes andaj ky mund të thotë dhe i ka bindjet dhe arsyet e veta, por unë i besoj raportit auditorit se ai gjitha ka me i auditu, me i kontrollu kështu që unë po dua me thënë mos u ngutni sepse mandej nuk po mundeni me i mbrojt deklarimet e juaja kështu ka ndodh edhe në të kaluaren.

z. Agim Mani: Rrustem a e dini për çka je këtu, auditori e auditon ekzekutivin unë po i bëj pyetje ekzekutivit për çështjen e 31,000.00 € .

z. Agim Çaka: Në momentin që unë i votoj këto propozime kur del një propozim për një projekt kjo nuk domethënë që unë jam i kënaqët me juve dhe ecurinë e punëve që është bë, ajo nuk është temë që mundet mu debatu po është vend edhe kohë tjetër ku diskutohet se shpesh herë mundet me pas keqkuptime se nëse Agimi po i voton këto propozime, ky po mendojka sikur opozita në fakt unë jam opozitë. Unë pajtohem me procedurën që duhet me u zhvillu nuk dua me ndal një projekt për shembull sipas mendimit tim sheshi i qytetit aty që është bë katastrofë, kanë me qesh njerëzit mbas tridhjetë vjetëve e kanë me qesh sot. Kush e ka bërë këtë farë pune prej dronit me bë me këqyr doket diqysh si mirë nuk është bërë për dron, po është bërë për tok njerëzit që ecin për tokë kështu që jo veç ky projekt por njëqind projekte që janë bë. A ka mundësi me më dal dhjetë projekte që unë me kanë pushtet nuk i kisha bë por kjo çka është është Naim, e ka pushtetin janë votat po bëhet, tash vjen

momenti kur kemi me dal e kemi me diskutu dhe kemi me i numërua, çka është mirë, çka është keq, po me ndal nuk mundem me ndal. Ndërsa sa i përket mënyrës votimit, unë votoj për procedurë d.m.th. e kam qartë se çka po bëhet a më pëlqejnë apo nuk pëlqejnë ato projekte që janë bërë, a ka defekte, a ka vërejtje, ka shumë mirëpo si procedurë unë e votoj kështu që e kam për sqarim për qytetarët që janë tu na përcjell dhe për juve.

z. Agim Mani: Kryesues nuk më dha përgjigje për pyetjen që bëra, për këto mjetet që po rialokohen për rregullimin e terrenit sportiv në Glloboshicë, këtu a janë kanë mjetet e zotume apo nuk janë kanë?

z. Bahri Selimi: Këtu këtë vit na si komunë si ekzekutiv i kemi bere planifikime tona që nëpër disa lokalitete me u rregullua edhe terrenet sportive, e kemi filluar me Glloboshicë si lokalitetin më të largët për rinin e atjehit të cilët e kane me se vështiri me u kyç në terrene sportive, të cilët detyrohen me shkua në Tetovë edhe Kaçanik të Vjetër, pra e kemi filluar kështu për Glloboshicë d.m.th. tu i tejkalua interesat private, na punojmë për qytetarët, ne i kemi prioritet qytetarët. Tani deri në këtë vit këtë projekt e kemi të kodume me këtë emër, mjetet janë kanë dhe janë por nuk mundesh me ndryshua me projekt të ri por veç mundesh me lënë pa emër d.m.th. jemi duke i dërgu te ky kod, por tani ky prej këtij viti e tutje vazhdon ne terrene sportive për shembull e nisem këtë vit nuk kryhet krejt e përfundojmë vitin e ardhshëm por ne e nisemi nëse najë vonojnë e kryejmë d.m.th. vazhdimisht edhe buxheti që ka mu aprovua me 30 shtator apo kur ta keni seancën keni me vërejt aty që kemi lënë një kod për të Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport për terrene sportive d.m.th. këto mjete dërgohen aty vazhdimisht. Agim nuk na del buxheti sa kemi nevoja me buxhetin tonë po mundohemi çdo cent me shfrytëzu pse njëra prej arsyeve është që pesë vite asnjë cent nuk e kemi nga niveli qendror a me i lënë këto pa i shfrytëzua. Ne auditorin nuk e kemi të njofshëm as shok nuk i kemi, për planifikim dhe për financa marrim shpërblim prej grantit të performancës nga gjysmë milioni, domethënë qeveria Suedeze na jep dhe qeveria Zvicerane.

z. Agim Mani: Këto mjete nga drejtori siç e tha më herët po bartin që në të ardhmen me muajt me i bart prapë, kryesues nëse ti nuk e kupton dhe gjithmonë po ta tërheki vërejtjen për diçka që nuk e din. Tjetra gjithmonë po thirri në raportin e auditorit. Auditori e auditon zyrën brenda se le të del auditori te sheshi, le të del te rrugë "Idriz Seferit".

z. Bashkim Luma: Meqenëse u fol për terrene sportive Glloboçicë, është mirë me ditë që më shumë se dhjetë vite fshati Glloboçicë ka mungesë tereni, domethënë a është dashtë me prit këtë buxhetin tonë të parkingut nëntokësor që mos mu realizua dhe me i rialoku mjetet.

z. Bahri Selimi: Jo nuk është e vërtet se mjetet e parkingut nëntokësorë janë ende te parkingu.

z. Bashkim Luma: Shqetësim i imi si asambleist ka qenë që fshati Glloboshicë, meriton sallë sportit.

z. Bahri Selimi: Agim, si është bërë shkolla që është obligim i ministrisë?

z. Bashkim Luma: Në raportimet e Kryetarit del që është financim i ministrisë.

z. Bahri Selimi: Glloboshicë për terrene sportive janë mjetet, unë po them kemi me qitë te kodit i terreneve sportive veç a kemi mjete, ku të na mbesin dikun tepriç se këto mjete që mbetën te pa shpenzume janë kursime. Në ligjet tona janë kursime domethënë mbetet një shumë e pashpenzuar nuk domethënë me lënë ashtu ai është kursim, kontratat planifikimi d.m.th. planifikimi 100,000.00 € kontrata 80,000.00 € dhe 20,000.00 € janë kursim ata duhet me i ridistinu, rialoku, transferu dhe me i shpenzu.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë, u miratua me 16 votë Për, 6 votë Kundër nga LVV. Prezentë 22. Nuk janë prezent: Betim Shala, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Arta Avdiu. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

VENDIM

Për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01Nr.400/03-14313/24, të datës 28.06.2024, për Rialokimin e Mjeteve Buxhetore sipas Buxhetit të vitit 2024.

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 14:15. Nga 25 anëtarë sa ishin prezentë në këtë mbledhje, deri në fund të mbledhjes qëndruan 22 anëtarë. Me herët dolën: Betim Shala, Bashkim Krasniqi, Besnik Salihu, Raif Kasa, Arta Avdiu.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);

**Nga Mbledhja e VIII (tetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin
2024, mbajtur me 05.09.2024**

1. Kemal Murseli
2. Brahim Imishti.....
3. Hamide Luma
4. Kadri Krivenjeva
5. Lirije Dema.....
6. Rrustem Zenuni.....
7. Edon Baftiu
8. Selajdin Troni
9. Fatmir Bunjaku
10. Bashkim Krasniqi
11. Florina Lika-Vishi
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....
13. Agim Mani
14. Kadrije Lika-Troni
15. Burim Shehu
16. Naim Beça
17. Raif Kasa
18. Ernesta Krasniqi.....
19. Bashkim Luma
20. Arta Avdiu
21. Ardita Rrahmani
22. Besnik Salihu
23. Betim Shala,.....
24. Arlinda Rakoci-Raka.....
25. Edona Luzha.....
26. Ekrem Livoreka.....
27. Agim Çaka.....



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kaçaniku
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

DREJTORIA E ARSIMIT

Përgjigje në pyetjen e znj. Ardita Rrahmani: Unë kam dy shqetësime të cilat janë të përsëritura e të ripërsëritura, po thuajse ka kohë të gjatë që gjithë mandatit tim kam fol për to, e që punë konkrete kurrë nuk ka. Konkretisht ka të bëjë me shkollën fillore "Emin Duraku", d.m.th. e kam fjalën për objektin e vjetër ku nxënësit veç se kanë filluar mësimin, aty kushtet cilat janë e dini gjithsecili më mirë se unë, çka po ndodh për arsye se postime ndryshme po shohim por prapë asgjë konkrete nuk ka, a do të filloj nëse po kur dhe kur do të përfundoj?

Përgjigje: për ShFMU "Emin Duraku", nuk mund ta di se kur do të fillojnë punimet dhe kur do të kryhen sepse buxhetin për objektin e shkollës e ka MASHTI, por mund të ju dokumentojë se kur është lëshuar nga komuna Leja ndërtimore e objektit, që është dokumenti përfundimtar që e lëshon komuna. Bashkangjitur me përgjigjen e keni edhe Lejen ndërtimore.

Përgjigje në pyetjen e znj. Kadrije Lika Troni: Kam një pyetje për drejtorin e Arsimit dhe një pyetje për Kryetarin së pari urime për një vit të mbarë e të suksesshëm shkollorë 2024-2025, për juve si drejtorin e Arsimit dhe juve nxënës e mësimdhënës përderisa urojmë për një vit të mbarë nuk mundem më anashkalua edhe një shqetësim që me ka trondit mua së pari si nënë e së dyti si asamblesite dukuria negative e ngacmimit seksual nëpër shkolla ky akt i shëmtuar e për fatkeq del të jetë prezent edhe në shkollat tona ku para disa dite sipas raportimit të Policisë mediave në shkollën e fshatit Dubrav të komunës së Kaçanikut është denoncuar një ngacmim seksual i një nxënëse nga mësimdhënësi i saj kjo është një çështje e rëndësishme e cila duhet të adresohet me seriozitet dhe vendosshmëri në këtë seancë të Kuvendit pra kërkojmë nevojën për drejtësinë arsim përgjegjësi, për punën dhe veprimet e mësimdhënësve për masat e nevojshme për të siguruar sigurinë dhe mbrojtjen në mjedisin shkollor për të gjithë nxënësit situata të tilla të ngacmimit seksual janë të pa tolerueshëm dhe të rënda prandaj drejtor na tregoni hapat të cilat i keni ndërmarrë në lidhje me rastin ju si drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

Përgjigje: Mënjëherë pas pranimit të informatës për dyshimet e rastit në fjalë, DKA ka vepruar konform legjisllacionit në fuqi.

Me respect,
Drejtori: Zahir Doda



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo
Data: 22.08.2024



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik
Nr. vrojtimit i lejes: 06Nr.351/01-20056/24

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 02/L-28, neni 11, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit lëshon këtë

Leje Ndërtimore

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Drejtorja e Arsimit		
Adresa:	Rr."Qamil Ilazi", Kaçanik		
Telefoni:	044/225-351	Emaili:	zahir.doda@rks-gov.net

Për punët ndërtimore në vijim:		
Zona Kadastrale: Kaçanik	Nr. i parcelës kadastrale: 00665-0	GPS Koordinatat: 7521232 4677242

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri	
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria II-të	
Përdorimi i propozuar:	A përfshin projekti ndryshim të përdorimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
Objekt – SHFMU-së "Emin Duraku" me etazhitet B+S+P+2	
Përshkrimi: Drejtoria e Arsimit ka bërë kërkesë për kushte ndërtimore për ndërtimin e Objektivit - SHFMU-së "Emin Duraku" me etazhitet B+S+P+2. Gjithë procedura është kryer në bazë të Ligjit për Ndërtim. Pasi që lënda ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme dhe pasi që ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pajiset me leje ndërtimi. Ndërtimi duhet të kryhet sipas kushteve ndërtimore të miratuara në DUKMM, sipas situacionit me	

kordinata dhe Projektit Kryesor të dorzuar në DUKMM.

Pas plotësimit të dokumentacionit të kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, arrihet në përfundim që ky objekt të pajiset me leje ndërtimi.

Punimet në terren duhet të kryhen sipas projekteve të dorëzuara në DUKMM.

Vendim

Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka shqyrtuar aplikacionin tuaj për leje ndërtimore. Leja lëshohet nën kushtet e mëposhtme:

1. Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga projektuesi i projektit dhe nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.
2. Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e aprovimit, përveç nëse zgjatet afati.
3. Duhet të siguroheni se kontraktuesi i posedon në vendndërtim dokumentet e mëposhtme:
 - 1.3.1. Një kopje të kësaj leje ndërtimore.
 - 1.3.2. Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktorit.
 - 1.3.3. Së paku një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent.
 - 1.3.4. Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - 1.3.5. Libri dhe ditari i ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe fotografike, që dokumentojnë:
 - 1.3.5.1. Datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; dhe
 - 1.3.5.2. Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur.
 - 1.3.6. Kartela e aprovimit të inspektimeve, e vendosur në vend të dukshëm. Ruajeni të mos priset nga moti sepse do të ju duhet kur të aplikoni për certifikatë të përdorimit.
4. Duhet të dorëzoni një Njoftim mbi Qëllimin për të Filluar Ndërtimin së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore.
5. Duhet të kontaktoni organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin ose inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore; dhe
6. Pas përfundimit të punëve ndërtimore, duhet të aplikoni për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe Kodin.

Zyrtar për Ndërtimtari
dhe Urbanizëm

Rifat Muca

Drejtori i DUKMM

Qamilla Stagova

